



Udhëzim për përgatitjen e planit për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave urgjente të mundshme



**Црвен крст на Република Македонија
Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë**



**International Federation
of Red Cross and Red Crescent Societies**

Përmbajtja

Përgatitja e planeve

Kreu 1

Hyrje

Si të përdoret ky udhëzim
Çka është planifikimi gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente
Procesi i planifikimit të veprimit gjatë katastrofave
Pse nevojitet plan?
Çka planifikojmë?
Me cilin planifikojmë?
Kur planifikojmë?
Ku planifikojmë?

Kreu 2

Hapa për përgatitjen e planit për veprim gjatë katastrofave dhe planit për situata të mundshme urgjente

Hapi 1: Planifikim institucional gjatë katastrofave
Hapi 2: analiza e rreziqeve, gjendje të mjerueshme, kapacitete dhe rreziqe
Hapi 3: Identifikimi dhe mobilizimi i resurseve
Hapi 4: Paralajmërim i hershëm, sisteme për alarmim dhe nxitës
Hapi 5: Lidhje dhe komunikime
Hapi 6: Përgjegjësi sektore

Informacione për përkrahje

Kreu 3

Koordinim i brendshëm dhe i jashtëm

Koordinim i brendshëm
Koordinim i jashtëm

Kreu 4

Planifikim të implementimit dhe përcjellje

Trajnim dhe diseminim të planit për veprim gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente
Trajnime dhe simulime
Ripërtrirje dhe evaluim të planit

Kreu 5

Standarde për plane, llogaridhënie dhe lidhshmëri

Standarde dhe llogaridhënie
Lidhshmëri mes mjeteve nacionale, rajonale dhe ndërkombëtare (nga niveli lokal kah ai global)

Shtesa

Aneksa

Akronime

Asociacioni i Kombeve Juglindore të Azisë

ASEAN Association of South-East Asian Nations

Iniciativa për Planifikim më të Mirë

BPI Better Programming Initiative

Qendra koordinative për Preventivë Nacionale të Katastrofave në Amerikën Qendrore

CEPREDENAC Coordination Centre for National Disaster Prevention in Central America

Njësia për Koordinim dhe Programim

CPD Coordination and Programme Division

Njësia për Zhvillim Ndërkombëtar

DFID Department for International Development

Sistem informativ për Menaxhimin e katastrofave

DMIS Disaster Management Information System

Kornizë për Resurse për Menaxhimin e Katastrofave

DMRF Disaster Management Resource Framework

Njësias për Menaxhimin e Katastrofave

DMU Disaster Management Unit

Fondi Urgjent gjatë Katastrofave

DREF Disaster Relief Emergency Fund

Njësia për Ndhimë Humanitare të Komisionit Evropian

ECHO European Commission's Humanitarian Aid Department

Qendra Operative për Veprim në Situata Urgjente

EOC Emergency Operations Centre

Njësia për Përgjigje gjatë katastrofave

ERU Emergency Response Unit

Ekipi për Vlerësim dhe Koordinim

FACT Field Assessment and Coordination Team

Sisteme Gjeografike Informative

GIS Geographical Information Systems

Banka Zhvillimore Inter - Amerikane

IADB Inter American Development Bank

Komiteti i Përhershëm ndërmjet agjencive

IASC Inter-Agency Standing Committee

Komiteti ndërkombëtar i Kryqit të kuq

ICRC International Committee of the Red Cross

Ligji Ndërkombëtar për Veprim Gjatë Katastrofave

IDRL International Disaster Response Law

Teknologji Informative

IT Information Technology

Organizata Ndërkombëtare për Migrime

IOM International Organization for Migration

Mjekë pa Kufij

MSF Médecins sans frontières

NATOLidhja Veriore Atlantike

NATO North Atlantic Treaty Organization

Ekipi Nacional për Veprim gjatë Katastrofave

NDRT National Disaster Response Team

Organizata Joqeveritare

NGO Non-governmental Organization

Zyra për Koordinim të Çështjeve Humanitare

OCHA Office for the Coordination of Humanitarian Affairs

OSBE Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

OSCE Organization for Security and Cooperation in Europe

Ekipi Rajonal për Veprimtari gjatë Katastrofave

RDRT Regional Disaster Response Team

Procedura Standarde Operative

SOP Standard Operating Procedures

KB Kombet e Bashkuara

UN United Nations

UNDP Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara

UNDP United Nations Development Programme

UNICEF Fondi për Fëmijë të Kombeve të Bashkuara

UNICEF United Nations Children's Fund

UNHCR Komesariati i Lartë për të Ikurit të Kombeve të Bashkuara

UNHCR United Nations High Commissioner for Refugees

USAID Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar të SHBA

USAID United States Agency for International Development

Vlerësimi i Mjerueshmërisë dhe Kapaciteteve

VCA Vulnerability and Capacity Assessment

Programi Botëror për Ushqim

WFP World Food Programme

OBSH Organizata Botërore e Shëndetësisë

WHO World Health Organization

Shoqatë nacionale e Përgatitur Mirë

WPNS Well Prepared National Society

Kreu 1

Hyrje

Lëvizja ndërkombëtare e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe është lider në fushën e menaxhimit të katastrofave. Elementet bazë të cilat dalin nga mandati janë përgatitja efektive për përgjigje gjatë katastrofave gjatë situatave urgjente dhe përkrahje në mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut dhe respektimi i humanitetit. Përparësitë komparative të Lëvizjes janë numri i madh i të punësuarve dhe vullnetarëve në të gjithë botën, që kanë mundësi menjëherë të përgjigjen në nivel lokal, si dhe resurset e rëndësishme të 189 shoqatave nacionale dhe të Sekretariatit të Federatës Ndërkombëtare. Të gjitha këto 189 anëtarë të Federatës Ndërkombëtare i themelojnë aktivitetet e veta të shtatë parimeve themelore të humanitetit, paanshmërisë, neutralitetit, pavarësisë, shërbimit vullnetar, bashkimit dhe universalitetit.

Shumica e shoqatave nacionale kanë status të njohur nga qeveritë e veta për kryerjen e “rolit ndimues të pushteteve në zbatimin e aktiviteteve humanitare”. Shoqatat nacionale dhe Federata ndërkombëtare bashkëpunojnë me qeveritë dhe agjencitë për dhënien e përkrahjes në situata në krizë dhe janë të përkushtuar në sigurimin e përkrahjes në nivel lokal me qëllim që të përkrahet popullata më e mjeruar në rast të katastrofave. Aktivitetet të cilat zbatohen në secilin vend i kryejnë shumë vullnetarë që gjatë katastrofave janë të parat të cilat iu sigurojnë ndihmë atyre të cilët kanë nevojë.

Shumica e vendeve ballafaqohen me situata urgjente të cilat ndonjëherë janë aq serioze sa që nevojitet përkrahje humanitare nga Lëvizja Ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe. Këto katastrofa mund të dalin si rezultat i katastrofave natyrore, vërshimeve, thatësirave dhe cikloneve apo rreziqe tjera, siç janë mungesa e ushqimit apo ujit, epidemitë, katastrofat teknologjike apo natyrore, ndryshime ekonomike, shqetësime të brendshme apo konflikte të armatosura. Krizat emigruese dhe shpërnguljet e brendshme gjithashtu janë pasojë e gjendjeve humanitare urgjente dhe prandaj edhe ato llogariten për situata urgjente.

Si të përdoret ky udhëzim

Planifikimi i përgjigjes gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente është përgjegjësi për të cilën duhet të merret parasysh në të gjitha nivelet e organizatës. Federata ndërkombëtare rekomandon që shoqatat nacionale dhe zyrtat e Federatës Ndërkombëtare të përgatisin plan për veprim gjatë katastrofave të ndryshme me anekse për secilin rrezik individual, apo të përgatiten disa plane për situatë urgjente specifike për mbulimin e katastrofave të mundshme të lartë të rrezikshme. Shumë procedura për menaxhimin e situatës urgjente janë të ngjashme për të gjitha katastrofat, pa dallim se cili rrezik është në pyetje.

Informacionet të cilat paraqiten në kaptinat që vijojnë duhet të merren parasysh si udhëzime, në vend të tyre të shihet si rregulla strikte. Prioritetet në planifikim do të dallohen sipas kontekstit dhe vëllimit të situatës – në pajtueshmëri me faktin se a bëhet fjalë për situatë lokale, nacionale apo rajonale. Shumë është me rëndësi kur përgatiten plane për veprim gjatë katastrofave apo përgatitje të planeve për situata të mundshme urgjente të bëhet në bashkëpunim me institucionet të cilat janë përgjegjëse për implementimin apo miratimin e tyre. **Ky udhëzim ka për qëllim të sigurojë se planet për veprim gjatë katastrofave të Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe janë kualitative.**

Procesi i planifikimit është i rëndësishëm si vet plani. Në këtë drejtim, planifikimi për veprim gjatë katastrofave dhe situatave urgjente duhet të jetë aktivitet i cili vazhdimisht zhvillohet që na mundëson vazhdimisht t'i testojmë dhe përmirësojmë planet ekzistuese, të integrojmë partnerë të rinj dhe në kohë t'i mësojmë të punësuarit dhe vullnetarët tanë.

Aspektet kryesore të cilat shqyrtohen në këtë udhëzim janë:

- Procesi i planifikimit të përgjigjes gjatë katastrofave;
- Hapa lidhur me përgatitjen e planit;
- Komunikim dhe koordinim të veprimit gjatë katastrofave;
- Implementimi i planit, trajnim, ripërtrirje dhe evaluim; dhe
- Standarde, mjete dhe formate.

Liderët/menaxhuesit në Kryqin e kuq/Gjysmëhënës së kuqe janë përgjegjës për përgatitje, implementim dhe monitorim të planeve për veprimtari gjatë katastrofave dhe situatave urgjente të mundshme

1. Nivel lokal apo në nivel të bashkësisë

Në nivel komunal apo në nivel të bashkësisë lokale, shoqatat nacionale të Kryqit të kuq apo Gjysmëhënës së kuqe mund të luajnë rol të dobishëm në procesin e sigurimit të përkrahjes së organizimit të punës së komiteteve për planifikim në rast të katastrofave me qëllim që të përgatiten planet për gatishmëri gjatë katastrofave bazuar në nevojat e bashkësisë lokale. Rekomandohet përdorimi i mjetit Vlerësim të mjerueshmërisë dhe kapaciteteve dhe Moduli për trajnim për planifikim të përgatitjes gjatë katastrofave të Federatës ndërkombëtare. Trajnimet nga ndihma e parë janë edhe një shembull për kontributin e Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe në bazë të përgatitjes së bashkësive për situata urgjente. Përsikaj asaj, bashkësitë lokale mund të sigurojnë shumë informacione lidhur me rreziqet dhe kapacitetet personale.

2. Niveli nacional

Plani nacional për përgatitje dhe veprim gjatë katastrofave i merr parasysh dhe bën vlerësimin e rreziqeve potenciale, dhe i evaluon kapacitetet e shoqatës nacionale për veprim gjatë katastrofave dhe e përshkruan qasjen që duhet të ndërmerret në raste të situatave urgjente. Shoqatat nacionale të përgatitura mirë duhet të përcjellin procesin e planifikimit që është përshkruar në këtë dokument. Secila shoqatë nacionale duhet të ketë përgatitur planin e vet për veprim gjatë katastrofave. Roli institucional i shoqatave nacionale dhe përgjigja e planifikuar i shoqatave nacionale dhe përgjigja e planifikuar në rast të katastrofave duhet të njihet edhe nga pushtetet në shtetet ku veprojnë shoqatat nacionale. Kjo është miratuar në Konferencën ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe të mbajtur në vitin 2004 me miratimin e *Agjendës për Aksion Humanitar*.

3. Nivel rajonal dhe global

Në funksion të përkrahjes koordinuese të Federatës ndërkombëtare për shoqatat nacionale, delegacionet rajonale dhe njësitë pan-rajonale për veprim dhe menaxhim gjatë katastrofave (DMU) patjetër të përgatisin plane për fusha të rrezikshmepër përgatitje në raste të situatës urgjente. Këto plane duhet të inkorporojnë rreziqe specifike me potencial që të nxisin shkatërrimin e vëlimit i cili siguron ndihmë të madhe humanitare. Shoqatat nacionale dhe Federata ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe duhet të kenë përgatitur plan për ngjarje të tilla të mundshme, ku do të vërtetohen masat e duhura, marrëdhënie pune mes partnerëve dhe rolet dhe procedurat, si dhe shkaktarë të mundshëm të situatave të tilla urgjente. Përgjegjësit duhet t'i përmbahen procesit të vërtetuar të planifikimit të përshkruar në këtë dokument.

Çka është planifikimi i përgjigjes gjatë katastrofave dhe situatave urgjente

Planifikimi i përgjigjes gjatë katastrofave dhe situatave urgjente është drejtuar kah ndërtimi i parakushteve për përgatitjen e organizatës të parashikojë situatë të caktuar urgjente. Këtu nënkuptojmë menaxhimin e resurseve njerëzore dhe financiare, qasje në ndihmë urgjente, dhe procedura komunikuese.

Planifikimi i tillë mund të ndihmojë për lehtësimin e efekteve destruktive të një katastrofe të caktuar nëpërmjet sigurimit të ndihmës humanitare në kohë dhe efektive për njerëzit të cilët kanë nevojë. **Koha e harxhuar për përgatitjen e planit për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave urgjente në mënyrë të rëndësishme fiton kohë kur të ndodhë katastrofa.**

Zgjatja e sigurimit të shërbimeve mund të rezultojë me vuajtjen e panevojshme të individëve dhe familjeve të goditura nga një katastrofë e caktuar, dhe të krijojë vështirësi plotësuese për ata të cilët e sigurojnë përkrahjen. Planifikimi efektiv i përgjigjes gjatë katastrofave çon kah realizimi në kohë dhe efektiv të operacioneve për sigurimin e përkrahjes gjatë katastrofave. Kjo gjithashtu mundëson të mbështetemi në pritje reale të procesit.

QËLLIMI

Ky dokument siguron shqyrtimin e elementeve kyçe për përgatitjen e planit për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave urgjente. Ky udhëzim është më adekuat për personelin e shoqatave nacionale dhe Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe të cilat janë përgjegjëse për përgatitjen e planit për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave urgjente në nivel lokal, nacional dhe global.

- **Planifikimi institucional gjatë katastrofave**— Me këtë definohet vëllimi i përgjithshëm i aksionit humanitar të cilin duhet ta ndërmerr shoqata nacionale dhe/apo Federata ndërkombëtare e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe. Kjo bazohet në mandatin institucional të orgtanizatës, që siguron kornizë ku mund të definohen politikat, rregulloret, strategjitë dhe normat dhe kompetencat e kufizimet ligjore.
- **Plan për përgjigje gjatë katastrofave**— Planifikimi për përgjigje gjatë katastrofave nënkupton identifikimin, përforcimin dhe organizimin e resurseve dhe kapaciteteve me qëllim që të mundësojë nivel adekuat të përgatitjes dhe përgjigje efektive në katastrofë potenciale. Këtu nënkuptojmë: vërtetimin e roleve dhe përgjegjësisë, përgatitje të politikave, rregulloreve dhe procedurave; dhe identifikim dhe përgatitje të mjeteve për përgjigje (p.sh. Punën e ekipeve nacionale për përgjigje gjatë katastrofave, menaxhim të informacioneve etj). Planifikimi i përgjigjes gjatë katastrofave është me natyrë preliminare, bazuar në supozimet edukative për rreziqe, dhe nuk përpunon skenare specifike të katastrofave – si në rastin për përgatitjen e planeve për situata të mundshme urgjente. Pasi të ndodhë katastrofa, atëherë planet duhet të përcillen, evaluohen dhe adaptohen në situatën specifike.
- **Plane për situata të mundshme urgjente**— Ato bazohen në ngjarje specifike apo rreziqe të njohura në nivel lokal, nacional, rajonal apo bile edhe në nivel global (p.sh. Tërmete, vërshime apo parqitje të epidemive), dhe vërtetim të procedurave për marrjen e përgjigjeve adekuate, bazuar në resurset dhe kapacitetet të cilat do të jenë të nevojshme për sigurimin e përkrahjes adekuate.
- **Procedurat Standarde Operative (PSO)** —Ato janë procedura standarde të cilat e “operacionalizojnë” përgjigjen gjatë katastrofave dhe/apo planin për situatë të mundshme urgjente. Me fjalë të tjera, procedurat standarde operative e vërtetojnë mënyrën në të cilën individët apo njësitë do t'i

zbatojnë funksionet e tyre në pajtueshmëri me planin e vërtetuar (p.sh. Alarmimi dhe mobilizimi për përgjigje gjatë katastrofave, shpërndarje të ekipeve për vlerësim dhe zbatim të procesit të vlerësimit). Këto procedura standarde operative vërtetojnë se çka duhet të bëhet, kush është përgjegjës për ta zbatuar, dhe resurset e kapshme për atë qëllim. Ky udhëzim nuk i përpunon në vete procedurat standarde operative, por është paraqitur shembull në aneksin 12.

Procesi i planifikimit të përgjigjes gjatë katastrofave

Pse nevojitet plani?

Me rëndësi esenciale për përgjigje efikase dhe të suksesshme gjatë katastrofave është që të posedojë plan mirë të koordinuar, i cili në mënyrë maksimale i inkorporon resurset dhe ekspertizën e Lëvizjes. Gjatë situatës urgjente, është e nevojshme që të ndërmerret aksion i shpejtë dhe efektiv që kjo të realizohet, plani për përgjigje gjatë katastrofave dhe situata të mundshme urgjente pëatjetër të jetë i gatshëm dhe të është në fuqi para se të ndodhë katastrofa – së bashku me të gjitha resurset e nevojshme për realizimin e tij. Nëse nuk ndërmerret aksion adekuat apo nëse përgjigja zgjatet, mund të vijë deri në humbjen e panevojshme të jetës.

E vërteta është se shumë veçori mbeten të panjohura deri sa të ndodhë ndonjë katastrofë e caktuar. Prapë se prapë, me rëndësi esenciale është që të përgatiet plan preliminar për përgjigje gjatë katastrofave, që duhet t'i përmbajë resurset që vijnë:

- Shqyrtim i të gjitha resurseve të kapshme;
- Identifikim të vendeve për qëndrim gjatë situatave urgjente;
- Plan për aktivitete për shpërndarjen e ndihmës humanitare, duke kyçur identifikimin e furnizuesve, depove dhe mjeteve transportuese;
- Caktim të burimeve për furnizim me ujë gjatë situatave urgjente;
- Detaje për procedura doganore, për zbatimin e procedurave të shpejta doganore gjatë pranimi të ndihmës humanitare;
- Vërtetim të sistemit diriguës dhe procedurave të komunikimit;
- Sigurim të trajnimit për personelin i cili do të jetë i kyçur në aktivitete për përgjigje gjatë katastrofave;
- Aktivitete për ngritjen e vetëdijes dhe edukimit në bashkësi në bazë të përgatitjes në rast të situatave urgjente; dhe
- Identifikim dhe implementim të aktiviteteve kyçe për lehtësimin e pasojave nga katastrofat dhe aktivitete për t'ua bërë me dije para kohe.

Kujdesuni që të ketë zbatuar plane, pika fokale dhe resurse që të pranohen dhe merren resurse të jashtme kur të ketë nevojë.

Përskaj kësaj, plani për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente ndihmon që të sigurohet përgjigje koordinuese:

- Prej më herët janë sqaruar qëllimet, strategjitë, rolet dhe përgjegjësitë.
- Janë grumbulluar dhe analizuar informacione relevante.
- Janë paraparë vështirësi potenciale dhe janë bërë orvatje për tejkalimin e problemeve.
- Janë krijuar dhe përforcuar raporte me agjenci tjera, asociacione, organizata joqeveritare, qeveri dhe veprimtarë lokal.

Bashkëpunimi dhe koordinimi i madh i cili rezulton nga procesi i planifikimit shpeshherë është me rëndësi të madhe që të sigurohet përgjigje në kohë, efikase dhe efektive, me qëllim që në mënyrë optimale të shfrytëzohen resurset e patjetërsueshme. Gjithashtu, mund të sjellë deri në bashkëpunim të rritur në fushën e zbatimit të aktiviteteve për përgatitje dhe lehtësim të katastrofave, me çka do të ulen humbjet potenciale në rast të katastrofës.

Pse duhet të planifikohet?

Ky udhëzim është i dizajnuar që të ndihmojë në përgatitjen e planeve për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente për çdo lloj të gjendjeve urgjente humanitare, duke kyçur: situata urgjente komplekse, katastrofa natyrore dhe kriza tjera më të rëndësishme në të cilat ndoshta duhet të përgjigjen shoqatat nacionale të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe – qoftë me resurse personale, apo me ndihmën e shoqatave tjera nacionale, apo me përkrahjen e Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe apo Komitetit ndërkombëtar të Kryqit të kuq.

Planifikimi duhet të jetë adekuat në secilin kontekst dhe të merren parasysh më shumë faktorë, si për shembull: pranimi dhe koordinimi i përkrahjes nacionale, rajonale apo globale; burime potenciale të përkrahjes donatore; mundësi për ndodhje të katastrofës; dhe mjerueshmëria e popullatës.

Patjetër të përdoren kritere objektive që të vërtetohet ku dhe çka të planifikohet për Shoqatat nacionale dhe Federata ndërkombëtare e shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe duhet të përdorin harta për rreziqe të mundshme si mënyrë e prioritizimit gjatë planifikimit. Udhëzime shtesë në bazë të rëndësisë së analizimit të rreziqeve është paraqitur në Kreun 2. Në raste ku resurset janë të kufizuara, rrjeti i ekipeve për përgjigje gjatë katastrofave dhe rezervat e ndihmës për rreziqe të mundshme – në nivel lokal, nacional dhe rajonal.

Me kënd të planifikohet?

Plani përgatitet me punë në ekipe. Kontributi dhe përkrahje e njerëzve të ndryshëm në pozita të ndryshme (p.sh. udhëheqësia, udhëheqës të shërbimit profesional, bashkëpunëtorë profesional, vullnetarë, personal administrativ etj.), të nivele të ndryshme në kuadër të Lëvizjes (nivel lokal, nacional, rajonal dhe global), si dhe partnerët të jashtëm (p.sh. qeveria, partnerë të KB, organizata joqeveritare) mund të sigurojnë përkrahje esenciale të njerëzve të cilët e përgatisin planin. Shiko Kreu 3 ku janë paraqitur më shumë informacione në bazë të rëndësisë të koordinimit të mirë – të brendshëm dhe të jashtëm.

Gjatë formulimit dhe ripërtirjes së dispozitave dhe qëllimeve në plane, shoqatat nacionale duhet të komunikojnë me agjenci qeveritare dhe organizata joqeveritare të cilat janë të kyçura në fushën e veprimit gjatë katastrofave, në bazë të koordinimit të përgjigjes dhe përgatitjes së planeve të mundshme për situata urgjente.

Ngjajshëm me këtë, personeli i Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe përgjegjës për përgatitjen e planeve rajonale apo globale për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente patjetër t'i konsultojnë partnerët e vet në Lëvizje. Kjo do të ndihmojë të përmirësohet koordinimi, të ulët dyfishimi i mjeteve, të sqarohen rolet dhe pritjet, dhe të rritet efektiviteti i përgjithshëm i përgjigjes gjatë një katastrofe të caktuar.

Koordinimi i drejtpërdrejtë u mundëson shoqatave nacionale dhe delegacioneve të Federatës ndërkombëtare t'i ndajnë përgjegjësitë dhe në mënyrë adekuate t'i planifikojnë aktivitetet e veta.

Planifikimi është më efikas kur është rezultat i procesit participues i cili kyç të gjithë aktorët të cilët duhet të punojnë së bashku në raste urgjente. Plani për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente duhet të jetë dokument dinamik dhe planifikuesit duhet të nxisin kontrollim, kritika dhe diskutime tek ata të cilët duhet të miratojnë dhe/apo të zbatojnë pjesë individuale të planit.

Kjo do të thotë se plani duhet të jetë i diseminuar dhe i komunikuar para anëtarëve të këshillit ekzekutiv të shoqatës nacionale, para njësive të ndryshme në qendrën, organizatat komunale të Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe, dhe agjencive apo organizatave relevante të jashtme.

Kur të planifikohet?

Planifikimi për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave urgjente të mundshme është proces i cili vazhdimisht zhvillohet. Liderët në Kryqin e kuq / Gjysmëhënës së kuqe duhet ta inkorporojnë procesin vjetor të planifikimit, në kuadër të masave për zhvillim strategjik dhe llogaridhënie të shërbimit. Planet patjetër rregullisht të testohen dhe ripërtihen me qëllim që të revidohet mënyra e tyre relevante.

Në kohën kur situatat ndryshohen shpejtë, planet do të duhet shpesh të ripërtrihen, e kur në mes ekzistojnë rrethana normale, atëherë mjafton që planet të ripërtrihen më rrallë. Planifikimi duhet të promovohet si diçka me rëndësiprandaj edhe në rrethana relativisht normale planifikimi duhet të inkorporohet në planifikimin vjetor.

Koha e mirë për promovimin e përgatitjes apo ripërtrirjes së planit është pas ndodhjes së ndonjë katastrofe më të madhe. Secili planifikim fillon me vlerësim dhe analizën e rreziqeve, situatave, kapaciteteve, resurseve dhe roleve të mjeruara.

Planifikimi për situata të mundshme urgjente çdoherë duhet të bëhet kur ekziston rrizik i madh se mund të ndodhë situatë urgjente. Shoqatat nacionale dhe zyret e Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe gjithashtu duhet të planifikojnë para ndodhjes së katastrofave natyrore që kanë tendencë të përsëriten, për shembull vërshime sezonale, uragane, ciklone etj. planifikimi për situata urgjente të mundshme duhet të inkorporohet në të gjitha proceset e rregullta të planifikimit, kur për të ka nevojë.

Ku të planifikohet?

Planet për përgjigje gjatë katastrofave janë të patjetërsueshme në nivel nacional dhe nivele të tjera (mes cilave edhe në nivel rajonal dhe global), që të sigurohet koordinim dhe përgjigje efektive gjatë katastrofave të mëdha. Planet duhet të promovohen dhe vërtetohen nga ana e të gjitha shoqatave nacionale dhe delegacioneve të Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe kur për të do të ketë nevojë, e në pajtueshmëri me rreziqet, shpeshtimin dhe kompleksimin e katastrofave potenciale.

Planet dhe procesi i implementimit të tyre do të dallohet në pajtueshmëri me situatën e vendit dhe/apo rajonit të caktuar, kornizën institucionale, përfshirjen gjeografike, etj.

Niveli nacional

Shoqatat nacionale mund të kenë më shumë plane për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente, në pajtueshmëri me nevojat e vendit – secili plan do të ishte i kahëzuar për fushat adekuate të rrezikshme. Planet mund të përgatiten në aspekt të pikëpamjeve të ndryshme gjeografike, mes cilave në nivel lokal, nacionale, nën – rajonal dhe rajonal.

Nivel tejkuftar

(mes vendeve fqinje, apo në nivel nacional për rajone apo fusha fqinje në një vend)

Shumica e planeve përgatiten për vende të caktuara individuale; megjithatë, planet gjithashtu mund të përgatiten për më shumë vende apo për rajone ku duhet të merren parasysh çështjet tejkuftare. Kjo posaçërisht ka të bëjë me katastrofat e mëdha natyrore, siç janë uraganet apo ciklonet. Në raste të tilla, kur përgatitet skenari rajonal, shumë me rëndësi është të ekzistojnë konsultime mes planifikuesve për përgjigje gjatë katastrofave të të gjitha vendeve të goditura, e pastaj mund të përgatiten edhe plane individuale për përgjigje gjatë situatës urgjente për secilin vend individualisht.

Zyrat e Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe kanë dhënë kontribut se do të sigurojnë përkrahje për përgatitjen e planeve rajonale për përgjigje gjatë situatave urgjente.

Shumica e vendeve gjithashtu të përgatisin plen për përgjigje në situata të mundshme urgjente. Ato janë me rëndësi për sigurimin e përgjigjes në kërcënime specifike apo për planifikim në kontekst të caktuar specifik. Megjithatë, nuk duhet gjithmonë të planifikohet përgjigje në situatë të mundshme urgjente – posaçërisht në rast të vendeve më të vogla, pao kur konteksti nuk shpie në përgatitjen e këtij plani. Në raste të tilla, mjafton të ketë plan për përgjigje gjatë katastrofave të shoqatës nacionale.

Kreu 2

Hapa për përgatitjen e planit për veprim gjatë katastrofave dhe plan për situata të mundshme urgjente

Edhe pse ekzistojnë dallime të rëndësishme mes planit për përgjigje gjatë katastrofave dhe planit për situata të mundshme urgjente, në këtë kaptinë shqyrtohen komponentat të cilat janë pjesë përbërëse të dy llojeve të planeve.

Mbani mend se niveli i parë i planifikimit të përgjigjes gjatë katastrofave —e definon mandatin, politikat dhe kornizën juridike mbi të cilën shoqatat nacionale dhe Federata ndërkombëtare e shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe do ta themelojnë përgjigjen dhe planin e vet për situata urgjente.

Planin për përgjigje gjatë katastrofave i vërteton rreziqet, strategjitë për përgjigje, aksionet dhe kapacitetet në kontekst ku ekzistojnë rreziqe të ndryshme.

Nga ana tjetër plani për gjendje të mundshme urgjente, nënkupton edhe përgatitjen edhe rritjen e vëllimit të aktiviteteve që të sigurohet përgjigje efikase të shumë rreziqeve specifike, që identifikohen gjatë fazës së planifikimit të përgjigjes gjatë katastrofave.

Ekzistojnë gjashtë hapa kryesore të cilat janë pjesë integruese të përgatitjes së planeve për përgjigje gjatë katastrofave dhe planeve për situata të mundshme urgjente:

- | | |
|---------------|--|
| Step 1 | Planifikim institucional gjatë katastrofave |
| Step 2 | Analizë e rreziqeve, kapaciteteve, situatave të mjerueshme |
| Step 3 | Identifikim dhe mobilizim të resurseve |
| Step 4 | Paralajmërim i hershëm, sisteme për alarmim |
| Step 5 | Lidhje dhe komunikime |
| Step 6 | Përgjegjësi të sektoreve |

- Vlerësim të situatave urgjente
- Vazhdimësi të operacioneve gjatë situatës urgjente
- Ndihmë mjekësore dhe për shpëtim
- Shërbime shëndetësore
- Ujë, sanim dhe promovim të higjienës
- Ushqim
- Ndihmë humanitare
- Strehim
- Realizim të lidhjeve familjare
- Mbrojtje dhe siguri

- Logjistikë dhe transport
- Teknologji informative (TI) dhe telekomunikacione
- Komunikime dhe lajmërimë
- Monitorim dhe evaluim

Gjatë planifikimit do të përdoren informacione nga burime të ndryshme. Këto informacione patjetër të jenë nga burime të sigurt, të jenë me kualitet të lartë dhe të shërbejnë për qëllime më specifike në kudër të përpunimit të planit. Nëse ekzistojnë dyshime të caktuara lidhur me dobinë apo lojalitetin e informacioneve, ato duhet të jenë të notuara në dokument.

Në Aneksin 1 është paraqitur propozim struktura dhe përmbajtje minimale rekomanduese në krahasim me përgatitjen e planeve për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente.

Mbani mend! Planet për situata të mundshme urgjente fokusohen në katastrofa specifike që kanë rrezik të madh se mund të ndodhin dhe janë lidhur me nivel të lartë të mjerueshmërisë; ato në veçanti i paraqesin nevojat e mundshme humanitare, aktivitetet, resurset, sfidat dhe mangësitë e mundshme. Edhe pse edhe planet për përgjigje gjatë katastrofave dhe planet për situata të mundshme urgjente kanë hapa të ngjashëm, mundësia dhe niveli i të dhënave të cilat duhet të jenë të përmbajtura në to janë të ndryshme.

Hapi 1 Planifikimi institucional gjatë katastrofave

Ky nivel i parë i planifikimit siguron referenca të përgjithshme për aksion humanitar, në bazë të mandatit institucional, politikave, strategjive, standardeve dhe normave, dhe kornizës juridike të organizatës.

Shoqatat nacionale të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe i zbatojnë aktivitetet e veta humanitare në pajtueshmëri me parimet themelore dhe statutin e Lëvizjes, Kushtetutën e Federatës ndërkombëtare, si dhe statutet e shoqatave nacionale dhe ligjet në shtetet e tyre. Si ndihmës të pushteteve në zbatimin e shërbimeve humanitare, shoqatat nacionale kryejnë rolin ndihmës të pushteteve në vend në pajtueshmëri me nevojat e popullatës lokale. Megjithatë, ky rol ndihmës nuk i kufizon iniciativat e shoqatave nacionale të ndërmarrin aktivitete tjera humanitare në vendet e veta. Ato janë organizata nacionale autonome, të cilat i ndihmojnë pushtetet në vendet e veta nëpërmjet programeve personale. Shoqatat nacionale duhet të kenë bashkëpunim të ngushtë me pushtetet që të sigurohet respekti i të drejtës ndërkombëtare humanitare, të mbrohet integriteti i ëmblemës dhe të sigurohet respekti i parimeve themelore.

Literatura e rekomanduar:

- Parimet themelore;
- Parime dhe Rregulla të Ndhmës gjatë katastrofave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe;
- Përgjigje nga Sevila dhe Masat plotësuese;
- Fusha Dekreti humanitar dhe Standardet minimale për përgjigje gjatë katastrofave;
- Kodi i Sjelljes së Lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe Organizatat joqeveritare gjatë sigurimit të ndihmës gjatë katastrofave;
- Udhëzime për shoqata nacionale të përgatitura mirë;
- Iniciativa për Programim më të mirë;
- Dhurim i mirë humanitar.

Roli i saktë i shoqatës nacionale gjatë katastrofave duhet të definohet dhe caktohet me qeverinë e shtetit. Pastaj duhet të përgatitet rregullore adekuate, ku do të inkorporohet roli i shoqatës nacionale në planin nacional për përgjigje gjatë katastrofave të qeverisë.

Shoqatat nacionale duhet të përgatiten vetë për të siguruar dhe marrë ndihmë në rast të katastrofave. Këtu për shembull nënkuptohet se shoqata nacionale duhet të caktojë me qeverinë e vet marrje nga pagesa e tatimit dhe dogana për ndihmë humanitare për popullatën e mjeruar nga katastrofat. Shoqata nacionale gjithashtu duhet t'i caktojë procedurat për sigurim të shpejtë të vizës për personelin e Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe që do të merr pjesë në operacionet për sigurimin e ndihmës nëse ka nevojë për ndihmë nga Lëvizja më e gjërë.

Federata ndërkombëtare e shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe gjithashtu prej më herët duhet t'i caktojë rolet dhe mandatin juridik të rajonit / zonës, dhe të përgatisë dispozita planifikuese të bazuara në këto mandate dhe nevoja të parapara. (**shiko Aneksi 2**).

Organizata

Gjatë situatës urgjente, shumë agjenci në mënyrë gjenerale janë të kyçura në aktivitete për sigurimin e shërbimeve humanitare. Këto organizata mund të jenë agjenci për mbrojtje civile, armata, ministri të ndryshme përgjegjëse për menaxhim me situata urgjente, brigada zjarrfikëse, shoqata nacionale të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, si dhe agjenci tjera ndërkombëtare dhe organizata joqeveritare.

Është e madhe mundësia se shumë prej tyre do të kryejnë detyra të njëjta – siç është për shembull ndihma e parë, sigurimi i strehimit dhe ushqimit për popullatën e goditur nga katastrofa. Në situata të tilla, me rëndësi të madhe

është ekzistimi i koordinimit të qartë që të sigurohet se numri maksimal i njerëzve do të marrin ndihmë në afat sa më të shpejtë që mundet, dhe të tejkalohet dyfishimi i panevojshëm i shërbimeve dhe resurseve.

Për këtë shkak, secila agjenci duhet t'i identifikojë aktivitetet dhe shërbimet për të cilat do të jetë përgjegjëse në procesin e përgatitjes së planit për përgjigje gjatë katastrofave apo planit për gjendje të mundshme urgjente. Do të bazohet në kapacitetet dhe resurset ekzistuese, dhe parashikimet për angazhim të mundshëm në rast të situatave urgjente. Organizatat gjithashtu duhet të përcaktojnë se kush do të jetë përgjegjës dhe se kush do të sjellë vendime për secilin funksion dhe rol në mënyrë individuale në kuadër të strukturës së vet. Duhet të përgatiten procedura standarde operative në nivel lokal, rajonal dhe global si dhe procedura për identifikimin dhe vlerësimin e resurseve potenciale. **(shiko Aneksi 3).**

Menaxhim

Planet për përgjigje gjatë katastrofave dhe planet për situata të mundshme urgjente të shoqatave nacionale apo Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe duhet të përmbajnë procedura standarde operative, ku janë të vërtetuara qartë përgjegjësitë dhe kontaktet për **(shiko Aneksi 3):**

- Person përgjegjës për kontakt gjatë katastrofave;
- Anëtarë të ekipeve në secilin nivel operativ; dhe
- Individë përgjegjës për:
 1. Aktivizim të shërbimeve për sigurimin e përgjigjes adekuate;
 2. Komunikime me zyrën qendrore;
 3. Menaxhim të raporteve të jashtme dhe apeleve për sigurimin e ndihmës nga jashtë (fonde qeveritare dhe ndërkombëtare dhe mjete të siguruar nga populli);
 4. Komunikime me media;
 5. Koordinim dhe lidhje me agjenci dhe shërbime të tjera dhe;
 6. Kryerje të punës administrative.

Hapi 2 **Analiza e rreziqeve, kapaciteteve, situatave të mjeruara dhe rreziqeve**

Planifikimi i drejtë për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente patjetër të bazohet në analizën e rreziqeve të cilat ka mundësi të ndodhin në vend apo rajon. Këtu nënkuptojmë identifikimin e rreziqeve, dhe vlerësim të gjendjeve të mjeruara dhe kapaciteteve në nivel lokal, nacional apo rajonal **(shiko Anekset 4.a – 4.d për këtë hap)**. Pastaj mund të përgatiten skenare reale për qëllimet e planifikimit.

Skenare për Rreziqe dhe katastrofa

Para se të fillojë analiza e rreziqeve dhe gjendjeve të mjerueshme, duhet të përgatitet kornizë për rreziqe të mundshme ku së paku do të përmbahen elementet që vijojnë:

Fusha	Analiza e rreziqeve	Analiza e mjerueshmërisë
Njësia gjeografike e analizës	■ Vendi rajoni ■ Provinca / kantoni / qyteti ■ Rrethina apo komuna ■ Lokalitet apo vend i caktuar	■ Popullata ■ Bashkësia ■ Familja ■ Individidi
Korniza kohore	■ Periudha e paraqitjes së sërishme (korniza kohore) dhe incidenca. Për shembull: në muaj, në vit, në çdo 5 vjet, në dhjetë vjet etj.	■ Periudha në të cilën zbatohet mjerueshmëria e një grupi të cakuar ■ Data të informacioneve të shfrytëzuara dhe të analizuara
Ngjarje / fushat e analizës	■ Rreziqe më të rëndësishme / kërcënime në zonat gjeografike të cilat analizohen (tërmete, vërshime, errupsione vullkanike, uragane, thatësira, epidemi, rrëshqitje të tokës etj). ■ Tjetërsime në periudhën e incidencës si rezultat i ndryshimeve të mjedisit jetësor apo ndryshimeve klimatike.	■ Situata specifike të shfaqjes dhe mjerueshmërisë (p.sh. fizike, ekonomike, sociale, organizative, institucionale, edukative, kulturore etj)
Tregues për matje	■ Mundësi që të ndodhë përsëri ■ Fusha potenciale të cilat mund të goditen dhe mbulimi i territorit ■ Magnituda e dëmit dhe humbjeve. ■ Përqindje e popullatës së goditur ■ Tjetër	Tregues për secilën fushë: ■ Mjerueshmëri ekonomike, të hyra në familje, shkalla e papunësisë ■ Mjerueshmëri sociale, qasje në shërbime shëndetësore, infrastruktura. ■ Mjerueshmëri organizative, ekzistimi i trupave, plani për përgjigje gjatë katastrofave, sistemi për paralajmërim të hershëm. ■ Mjerueshmëri fizike: strehimore, lokalitet dhe kualitet të strukturave dhe vendbanimeve
Burime të informacioneve	Të sigurohen referenca specifike për burime të informacioneve të shfrytëzuara si mjet për verifikim.	

Në bazë të analizës së rreziqeve potenciale, incidenca e katastrofave paraprake, dhe mjerueshmëria e popullatës, planet e përgjigjes gjatë katastrofave duhet të jenë në mundësi të përpilojnë listën e nevojave të mundshme, dhe t'i identifikojnë resurset e kapshme. Nëse planerët parashikojnë mangësi në bazë të nevojave dhe resurseve, atëherë duhet paraprakisht të gjendet mënyrë se si ato të sigurohen në rast të situatave urgjente.

Hapat për analizën e rreziqeve, kapaciteteve, situatave të mjeruara dhe rreziqeve

1. **Shqyrtim të të dhënave sekondare**— duke kyçur studimet dhe analizën e rreziqeve, situatave të mjeruara dhe rreziqeve të përgatitura nga ana e institucioneve të specializuara apo studimore, universiteteve apo organizatave tjera të cilat janë të pranishme në fushë (shiko më lartë kornizën për rreziqe referuese).
2. Të sigurohet që institucioni të ketë **kapacitet** teknik dhe përvojë adekuate për zbatimin e analizës për rreziqe për nevojat e përgatitjes së planit për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente. Për tu ndihmuar kjo, mund të nënshkruhen marrëveshje për bashkëpunim me institucione universitare teknike – shkencore. Shoqata tjera nacionale dhe Federata ndërkombëtare e shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe shpesh herë mund të sigurojnë përkrahje teknike dhe mjete për këtë qëllim.
3. Zbatimi i **analizës së rreziqeve**, duke filluar me informacionet e kapshme për situata urgjente që kanë ndodhur në të kaluarën dhe marrja parasysh e mundësisë se sa shpesh atë përsëri të ndodhin, lokaliteti, magnituda e tyre e mundshme dhe ndikimi potencial. Kujdes: Mos u mbështetni vetëm në të dhëna historike. Merrni parasysh rrethanat ekstreme kohore me ndryshime klimatike, ndryshime më të mëdha në krahasim me rreziqet si rezultat i prerjes së pyejeve, urbanizim i paplanifikuar etj. përsëri kësaj është mirë të shfrytëzoni ekspertizën e agjencive të jashtme që më mirë të kuptohen këto fakte.
4. Analiza e nivelit të **mjerueshmërisë** së personave të cilët janë të shfaqur në rreziqe/kërcënime potenciale. Kur ka mundësi, kjo duhet të mbindërtohet me tregues të cilët masin pesë komponenta kryesore të mjerueshmërisë: mjete për ekzistim, mirëqenie, vet-mbrojtje, mbrojtje sociale dhe mbrojtje qeveritare.
5. Zbatimi i **analizës së rreziqeve**, nëpërmjet kombinimit të rreziqeve/kërcënimeve dhe mjerueshmërisë. Bëni harta ku do të theksoni fushat me rreziqet potenciale. Ndani dhe bëni prioritete në bazë të zonave gjeografike që ndoshta do të duhet të përkrahen në rast të skenareve të caktuara.

Për zbatimin e analizës kualitative të rreziqeve ndoshta do t'ju nevojiten resurse dhe kapacitete teknike të cilat jo gjithmonë janë të kapshme në Kryqin e kuq / Gjysmëhënën e kuqe. Që të bëhet analizë solide, nevojitet që të kërkonti këshillë dhe bashkëpunim me agjenci profesionale qeveritare, institucione shkencore, universitete dhe organizata tjera të specializuara.

Rreziku nga paraqitja e katastrofës është i lidhur me mjerueshmërinë e popullatës në krahasim me kërcënim të caktuar; si dhe rrethanat e ndryshueshme të cilat mund të ndikojnë në nivelin e mjerueshmërisë. Planifikimi i mirë patjetër gjithashtu të bëjë vlerësimin e kapaciteteve në bashkësi të cilat janë të shfaqura në rrezik, dhe të identifikojë mundësi dhe mekanizma për përforcimin dhe rritjen e kapaciteteve – gjatë planifikimit dhe gjatë ndërmarrjes së aktiviteteve për përgjigje.

Analiza e skenarit për situatë urgjente duhet t'i përmbajë elementet që vijnë:

- Numri i njerëzve të shfaqur në rreziqe
- Lokaliteti gjeografik
- Ndikimi potencial
- Ndikime të tanishme
- Klima
- Topografia
- Burime kryesore të mbajtjes së popullatës (mënyra e sigurimit të ekzistencës).

Siç u përmend, rekomandojmë përdorimin e studimeve ekzistuese apo treguesve për mjerueshmëri nga burime të besueshme të të dhënave sekondare (burime akademike, qeveritare, studimore etj.) vlerësimi participativ i zbatuar i mjerueshmërisë dhe kapaciteteve, bile edhe në rast të vlerësimit ende të vazhdojë, do të na mundësojë kontribut të rëndësishëm për planet (për kërcënime të lokalizuara apo në fusha të definuara mirë),

Sapo të zbatohet analiza e rreziqeve dhe pasi të kompletohet analiza e situatës së mundshme urgjente, hapat vijuese që duhet të ndërmerren janë:

- Zbatimi i vlerësimit të mjerueshmërisë dhe kapaciteteve në fushat e rrezikuara.
- Elaborimi i planeve për gatishmëri dhe veprim gjatë katastrofave

- Implementimi i projekteve për lehtësimin e gjendjeve, aty ku ka nevojë.
- Përkrahje të iniciativave për mbindërtimin e kapaciteteve në nivel nacional dhe lokal dhe në nivel të bashkësive.

Nivelet e mjerueshmërisë

Mënyra e thjeshtë për definimin e niveleve të mjerueshmërisë për fushë apo zonë të caktuar gjeografike është nëpërmjet përdorimit të kategorizimit të mjerueshmërisë (të lartë, të mesme apo të ulët), siç është paraqitur në tabelën më poshtë:

Niveli i mjerueshmërisë	Karakteristika
I ulët	■ Në mënyrë gjenerale njihet rreziku/kërcënimi i caktuar. Popullata e goditur është e njoftuar me karakteristikat dhe paraqitjen e mundshme të rrezikut/kërcënimit gjatë një periudhe të caktuar kohore. ■ Ka nivel të lartë të përgatitjes organizative dhe kapacitet për përgjigje në katastrofë të mundshme.
I mesëm	■ Edhe pse kërcënimet nuk mund të identifikohen lehtë, ekziston nivel i caktuar i rrezikut potencial, e ku përgatitjet organizative dhe kapacitetet për përgjigje në katastrofa janë të pamjaftueshme.
I lartë	■ Ndoshta ekziston njohuri me shfaqjen e rreziqeve / kërcënimeve, por për këtë përkushtohet më pak vëmendje apo aspak nuk i përkushtohet vëmendje. ■ Nuk ekziston informacion për aksione për paralajmërim dhe përgatitje të cilat duhet të implementohen. ■ Ato që janë shfaqur në rrezik/kërcënim të caktuar nuk kanë mjaft kapacitete për ndërmarrje të përgjigjes adekuate.

Analiza e mjerueshmërisë

Që të llogaritet rreziku i katastrofave të mundshme, patjetër duhet të definohet mjerueshmëria e popullatës të shfaqur në rreziqe / kërcënim të caktuara. Planifikuesit mund të vërtetojnë nivele të mjerueshmërisë duke marrë parasysh më shumë faktorë të ndryshëm. Nëse një kontekst i caktuar obligon analizë detale të mjerueshmërisë, identifikim të grupeve të treguesve për çdo fushë të mjerueshmërisë, dhe rangim të tyre si mënyrë për definimin e mjerueshmërisë të përgjithshme. Tabela në vijim siguron shembuj të caktuar:

Fusha e analizës Nivel nacional apo rajon	Shembuj të treguesve
Mjerueshmëri fizike	■ Kualitet i mjeteve për komunikim ■ Prani dhe kualitet të infrastrukturës publike dhe strehimoreve. ■ Prani dhe kapshmëri të rrugëve për evakuim në rast të katastrofave ■ Kualiteti i konstrakteve për qëndrim ■ Afrësia e shtëpive apo qendrave të banuara në rreziqet / kërcënimet e identifikuara.
Mjerueshmëri organizative	■ Ekzistim, efektivitet dhe vetëdije për: ■ Sisteme për paralajmërim të hershëm ■ Sisteme dhe plane për veprim gjatë katastrofave ■ Ekzistim të ekipeve komponente për përgjigje gjatë katastrofave ■ Ekzistim të projekteve zhvillimore dhe organizatave joqeveritare (lokale dhe ndërkombëtare) ■ Ekzistim të organizatave në bashkësitë lokale, grupet sociale etj. ■ Mënyra të sigurimit të shërbimeve elementare për popullatën ■ Sjellje të vendimeve të centralizuara / decentralizuara gjatë menaxhimit të katastrofave
Mjerueshmëri institucionale	■ Ekzistim të organizatave të cilat sigurojnë ndihmë / përkrahje siç janë Kryqi i kuq / Gjysmëhëna e kuqe, zjarrfikësit, policia, mbrojtja civile etj. ■ Resurse njerëzore posaçërisht të dedikuara për veprim gjatë katastrofave ■ Resurse financiare posaçërisht të dedikuara për përgatitje dhe veprim gjatë katastrofave ■ Vetëdije dhe përkushtim të pushteteve lokale për uljen e katastrofave ■ Legjislativë, plane dhe udhëzime për menaxhim lokal / nacional të katastrofave ■ Qasje në popullatën e mjeruar në situata të katastrofave. ■ Përgatitje dhe kualitet të mekanizmave për marrjen e ndihmave të jashtme dhe ndërkombëtare.

Analiza e mjerueshmërisë mund të jetë detale dhe vëllimore sipas dëshirës, përderisa informacionet ripërtrihen rregullisht dhe janë me kualitet të mirë. Shkalla e kësaj analize gjithsesi do të varet nga resurset e kapshme dhe koha. Në të shumtën e rasteve rekomandohet hapi i parë të jetë një makro analizë gjithëpërfshirëse apo profilim i të gjitha rreziqevetë cilat mund të ndodhin në vend apo rajon.

Kjo do t'i sigurojë pasqyrë të tërësishme shoqatës nacionale dhe partnerëve tjerë të Lëvizjes, dhe do të ndihmojë në vërtetimin e prioriteteve në bazë të fushave me rrezik të lartë gjatë procesit të planifikimit. Në rast kur kërcënohet rrezik i pashmangshëm procesit të planifikimit të situatës urgjente (për shembull keqësim i shpejtë i stabilitetit në vend), analiza (dhe procesi i planifikimit të situatës së mundshme urgjente) duhet të kahëzohet në këtë rrezik / kërcënim potencial. Kjo gjithashtu do të sigurojë bazë për selektimin e treguesve më adekuat për paralajmërim të hershëm që do të përdoren gjatë monitorimit të situatës.

Duke pasur parasysh se planifikimi për situatë të mundshme urgjente nënkupton edhe përgatitjen e planeve për situata të caktuara specifike, vështirë është të përgatiten plane për situata të mundshme urgjente që të përfshihen të gjitha mundësitë. Për këtë, është patjetër të bëhet përparësi dhe të përgatiten planet për situata të mundshme urgjente bile për skenaret më të rrezikshme të identifikuar.

Në bazë të analizës së rreziqeve, shoqatat nacionale dhe Federata ndërkombëtare e shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe duhet të drejtohen në planifikimin dhe përgatitjen e skenareve për situatat më relevante – në nivel lokal, nacional dhe rajonal. (shiko aneksi 5)

Hapi 3 Identifikimi dhe mobilizimi i resurseve

Dy prej elementeve më kryesore gjatë përgatitjes së planit për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente janë:

1. Analiza e kapaciteteve
2. Identifikimi i resurseve

Shumë është me rëndësi që informacionet për kapacitetet dhe resurset të jenë të sakta dhe të besueshme – për shkak se ato paraqesin bazë për identifikimin e mangësive dhe dobësive, si dhe për optimizimin e përdorimit të resurseve ekzistuese.

Gjithashtu, kapacitetet ekzistuese mund të përforcohen në mënyrë strategjike, me qëllim në mënyrë sa më të mirë që të vërtetohen nevojat gjatë katastrofës potenciale. Pasi të vërtetohen nevojat potenciale në situata urgjente, do të jetë e qartë në mënyrë sa më të mirë të ndahen resurset ekzistuese dhe të shihet se cilat janë nevojat plotësuese.

Nuk ekziston formulë e thjeshtë apo listë e saktë të gjërave të cilat duhet të bëhen që të tregohet se si analizohen saktë kapacitetet dhe se si identifikohen resurset. Këto elemente dallohen varësisht nga konteksti dhe sipas skenarit në çështje. Prapë se prapë, në planifikimin e Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe, mund të identifikohen pesë kategori kur shqyrtohet çështja e resurseve (shiko aneksi 6 dhe aneksi 7):

1. Kapacitetet dhe resurset në nivel të bashkësisë – duke kyçur edhe qasjet participuese në bazë të kategorive të posaçme të popullatës, si dhe sektorin publik dhe privat.
2. Kapacitetet dhe resurset e Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe në nivel nacional dhe komunal.
3. Kapacitete dhe resurse rajonale dhe ndërkombëtare institucionale, duke kyçur edhe përgatitjen për kërkesë dhe marje të resurseve nga Lëvizja.
4. Kapacitete dhe resurse të jashtme institucionale.
5. Marrëveshje me partnerë të tjerë.

Për tu përgjigjur me sukses në situata urgjente nevojiten resurse, dhe plani për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente patjetër të ketë parasysh nivele të ndryshme të përgatitjes. Që këtu, nevojitet të merren parasysh gjërat që vijnë:

- Cilat resurse tani më janë të kapshme dhe në çfarë sasive, për sa njerëz dhe për sa periudhë kohore?
- Në cilën mënyrë mund të përfordhen dhe rriten resurset dhe kapacitetet në bashkësi?
- Tek cilët të punësuar dhe vullnetarë të programeve tjera mund të llogaritet në rast të situatës urgjente?
- Cilat resurse do të jenë të nevojshme e që për momentin nuk janë të kapshme?
- Çfarë plane ekzistojnë për furnizimin e resurseve të nevojshme?
- Çfarë plane dhe përgatitje ekzistojnë për marjen dhe menaxhimin e ndihmës humanitare?

Informacionet patjetër të ripërtrihen në bazë të rregullt. Kjo është me rëndësi të posaçme për regjistrat me personel dhe kompetencat e tyre, si dhe regjistrimi i pajisjes dhe resurseve logjistike. Për shembull, data baza për vullnetarë ndoshta nuk e reflekton më së miri gjendjen momentale për shkak se në periudhën e fundit nuk ka bërë hartim adekuat të resurseve njeërzore në Kryqin e kuq / Gjysmëhënën e kuqe, apo në regjistrat për mallëra dhe pajisje nuk është theksuar se një pjesë prej tyre nuk janë për përdorim për shkak të mirëmbajtjes së keqe.

Në raste të tilla, duhet të kërkohet ndihmë nga të gjithë personat përgjegjës të cilët mund t'i sigurojnë informacionet e nevojshme.

Mjeti për vlerësim të shoqatave nacionale të përgatitura mirë gjithashtu mund të ndihmojë në identifikimin e kapaciteteve dhe resurseve ekzistuese të një shoqate nacionale të caktuar.

Hapi 4 Paralajmërim i hershëm, sisteme për alarmim dhe nxitës

Procesi i planifikimit të përgjigjes gjatë katastrofave duhet të ketë parasysh se në cilën mënyrë do të paralajmërohet popullata për situatë të caktuar urgjente, dhe t'i identifikojë personat të cilët duhet të bëjnë lajmërimin e të tjerëve. Duhet të ketë sisteme të zbatuara në bashkëpunim me organizatat tjera të cilat do t'i përcjellin katastrofat (p.sh. Institucione qeveritare, byroja për meteorologji, institucione shkencore etj). me qëllim që të sigurohet zyrat e Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe të jenë në listat për lajmërim dhe aktivizim.

Përskaj kësaj, ekzistojnë më shumë institucione dhe qendra meteorologjike për ingjineri të tërmeteve të cilat i përcjellin katastrofat dhe përgatisin raporte për ato. Sistemi informativ për Menaxhim me Katastrofa i Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe (DMIS) përmban linqe të dobishme deri në një pjesë të këtyre qendrave globale për monitorim.

1. A ka përgaditur shoqata nacionale procedura për paralajmërim të hershëm në bashkëpunim me institucione meteorologjike, gjeologjike dhe të tjera të cilat janë profesionistë në këtë fushë?
2. A ka zbatuar procedura për paralajmërim të hershëm Federata ndërkombëtare e shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe në institucionet shkencore rajonale meteorologjike, gjeologjike etj?
3. A ka zbatuar shoqata nacionale dhe Federata ndërkombëtare e shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe procedura për sigurimin e informacioneve për DMIS?
4. A ka zbatuar qendra e shoqatës nacionale procedura për paralajmërim të hershëm me organizatat komunale të Kryqit të kuq?

Shoqatat nacionale duhet të caktojnë dikë (përveç personit për marëdhënie me publikun) i cili do të jetë përgjegjës për ndarjen e informacioneve me mediat. Ky person duhet të ketë përvojën e duhur dhe kontaktet me përfaqësuesit qeveritarë, sektorin korporativ dhe sektorin qytetar.

Menaxhmenti i shoqatës nacionale dhe / apo shefi i delegacionit të Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe duhet të caktojë se kush do të komunikojkë me mediat. Anëtarët tjerë të ekipit për përgjigje gjatë katastrofave duhet t'i kahëzojnë të gjitha çështjet lidhur me komunikimet apo marëdhëniet me publikun tek personi përgjegjës, që të tejkalohet hutia dhe të sigurohet përcjellje në komunikimin e brendshëm. Përveç kësaj duhet të përgatiten porosi standarde dhe teza për diskutim, dhe të bëhet trajnim për anëtarët kyç të ekipeve në bazë të komunikimit efektiv në këto teza dhe porosi.

Në kushte kur pushtetet nuk kanë sisteme adekuate për lajmërimin e opinionit për katastrofë të mundshme, shoqatat nacionale mund të zbatojnë rrjete lokale për pranimin e porosive dhe veprim në rast të paralajmërimit të marur, me qëllim që të ngrihet vetëdija e publikut për rreziqe potenciale dhe ndërmarrje të aksioneve adekuate.

Hapi 5 Lidhje dhe komunikime

Sistemi informativ gjatë katastrofave obligon posedimin e aftësive dhe metodave të posaçme. Shoqatat nacionale, delegacionet rajonale dhe sekretarijati i Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe duhet të zbatojnë procedura menaxhuese informative në kuadër të situatave të mundshme urgjente në pesë fushat vijuese:

1. Informimi i opinionit
2. Informimi operativ
3. Informimi i brendshëm
4. Dorëzimi i raporteve
5. Komunikim institucional

Secila fushë ka qëllime të ndryshme dhe për këtë duhet për secilën prej tyre të vepronet në mënyra të ndryshme.

1. Informimi i opinionit ka të bëjë me mediat lokale, nacionale, rajonale dhe ndërkombëtare. Në planin për përgatitje duhet të merret parasysh ky aspekt si dhe nevoja për zëdhënës i cili flet më shumë gjuhë. Gjithashtu duhet të merren parasysh edhe dallimet kohore të zonave.
2. Informimi operativ është me rëndësi esenciale për bartje efektive të vendimeve dhe duhet të menaxhohet nga ana e qendrës operative për veprim në situatë urgjente.
3. Ndarja e brendshme e informacioneve ka për qëllim të sigurohet rrjedhje adekuate e informacioneve tek të gjithë të punësuarit dhe vullnetarët në bazë të çështjeve specifike dhe relevante lidhur me operacionin urgjent.
4. Patjetër të respektohen normat për dorëzimin e raporteve dhe lajmërimit në nivel nacional, rajonal dhe ndërkombëtar si mjet për llogaridhënie. Procesi i lajmërimit duhet të jetë mirë i planifikuar, me ripërtirje të rregullt të informacioneve.
5. Komunikimi institucional duhet ta përparojë koordinimin në kuadër të shoqatës nacionale, mes anëtarëve të Federatës ndërkombëtare dhe me komponentat tjera në Lëvizje, si dhe me agjenci tjera.

Shpërndarja dhe këmbimi i informacioneve me përfaqësuesit të agjencive tjera është me rëndësi të posaçme gjatë situatave urgjente. Me qëllim që të sigurohet komunikim i qartë dhe efektiv gjatë situatave urgjente, në plan duhet të theksohet se si do të zhvillohet komunikimi dhe nëpërmjet cilit medium (p.sh. e-mail, radio, faks, telefon, sy më sy, mbledhje koordinative, etj. Shiko Aneksi

8). Kjo gjithashtu ka të bëjë edhe me komunikimet në Kryqin e kuq / Gjysmëhënën e kuqe në nivel lokal (në kuadër të shoqatës nacionale dhe / apo me OKKK), në nivel ndërkombëtar (komunikimet me Sekretariatit e Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe në Gjenevë) dhe me shoqata nacionale partnere të cilat tani më kanë zyra në vend.

Shumë qeveri kanë qendra të posaçme nacionale operative për raste të situatave urgjente apo katastrofave, shërbim përgjegjës apo grup koordinues, në kuadër të së cilave aktivizohet dhe alarmohet edhe Kryqi i kuq / Gjysmëhëna e kuqe. Rekomandohet caktim i personit përgjegjës i Kryqit të kuq në këto trupa të sigurohet koordinim dhe komunikim efektiv.

Një mangësi e posaçme, notuar në operacionet e mëparshme për përgjigje gjatë katastrofave, ka të bëjë me mos ndarjen e informacioneve nga vlerësimi i zbatuar – që më pas shpesh herë dyfishohet apo nuk është complete. Planifikimi për përgatitje gjatë katastrofave duhet ta theksojë rëndësinë e ndarjes së informacioneve në të gjitha nivelet, në Lëvizje dhe me partnerë tjerë.

Marrëdhëniet me mediat gjithashtu duhet të përforcohen. Përvojat e kaluara tregojnë se shpesh herë informacionet në teren varen në bazë të kualitetit. Zgjidhja praktike për këtë problem është të sigurohen ekipe për në teren që do të mund të mbledhin të dhëna kualitative digjitale dhe audio. Planet duhet të kenë mekanizmapër shpërndarjen e informacioneve për aktivitete të Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe në bashkësitë e goditura, me qëllim të ngritjes vetëdijja për rreziqet dhe për qasjen në ndihmat humanitare në rast nevojë.

Hapi 6 Përgjegjësitë e sektoreve

Planet për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente duhet të përmbajnë informacione të rezumuara, sipas sektoreve, në bazë të asaj se si mund të mbulohen dhe kënaqen nevoja dhe funksione të caktuara në sektore të ndryshme, duke kyçur edhe caktimin e roleve dhe përgjegjësi.

Sektorët kryesorë të cilat duhet të merren parasysh mund të paraqiten në mënyrë të shumuar në mënyrën që vijon:

Rolet e sektoreve mund të lëvizin nga njëra shoqatë nacionale në tjetrën. Është me rëndësi të përmendet se në të shumtën e rasteve, qeveria e mban përgjegjësinë gjenerale për aktivitetet për përgjigje gjatë katastrofave. Për këtë, është shumë me rëndësi të definohet se cili do të jetë roli i Kryqit të kuq, në cilën mënyrë do të merr pjesë shoqata nacionale dhe se si do t'i koordinojë aktivitetet e veta në sektorin e vet, posaçërisht me bashkësitë lokale dhe veprimtarët tjerë të cilët sigurojnë përkrahje.

Fushat / sektoret më relevante për sigurimin e shërbimeve të Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe janë të përshkruara më poshtë:

1. Vlerësimi i gjendjes urgjente
2. Vazhdimësi në operacionet gjatë situatës urgjente
3. Shpëtim dhe ndihmë mjekësore
4. Shërbime shëndetësore
5. Ujë, sanim, dhe promovim të higjienës
6. Ushqim dhe ushqyerit
7. Ndihmë humanitare
8. Sigurim të strehimores
9. Zbatim të lidhjeve familjare
10. Mbrojtje dhe siguri
11. Logjistikë dhe transport
12. IT dhe telekomunikacion
13. Komunikime dhe lajmërim
14. Monitorim dhe evaluim

Edhe pse është me rëndësi që këto sektore në mënyrë individuale të jenë të përfshira në procesin e planifikimit, vetë sigurimi i shërbimeve (nga ana e shoqatave nacionale, Federata ndërkombëtare e shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe partnerë të jashtëm) në fund do të varet nga nevojat individuale në bashkësitë lokale, varësisht nga mënyra relevante e sektoreve individuale për sigurimin e ndihmës adekuate dhe efektive. Thëks primar duhet të vendoset në përforcimin e kapaciteteve të bashkësive për sigurimin e ndihmës dhe rimëkëmbje, dhe zbatim të bashkëpunimit të mirë mes agjencive të cilat sigurojnë ndihmë që të sigurohet se të gjitha mangësitë e rëndësishmedo të jenë të përfshira me veprimtaritë.

Në segmentet në kuadër të menaxhimit me katastrofa (p.sh. përgjigje, përgatitje për përgjigje, lehtësim të gjendjeve, ulje të rreziqeve etj) patjetër të shikohet si një tërësi e cila vazhdimësinë e vet. Me uljen e aktiviteteve për ndarjen e ndihmës humanitare, do të fillojë intensifikimi i aktiviteteve për rimëkëmbje dhe ulje të rreziqeve (përgatitje gjatë katastrofave dhe lehtësim të gjendjeve). Të gjitha këto elemente të menaxhimit të katastrofave patjetër mes veti të përkrahen për shkak se asnjë nuk mund të implementohet në vete.

Komponentat elementare për secilin sektor, relevante për planifikimin e përgjigjes gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente, të theksuara në detaje në tekstin e mëposhtëm. Gjithashtu me rëndësi është të përmendet se Federata angazhohet kah zbatimi i *Sferës së Dekretit humanitar dhe Standardeve Minimale për Përgjigje gjatë Katastrofave* – një mjet shumë i mirë ku janë theksuar standarde detale për sektorët në vijim: ujë dhe sanim, promovim të higjienës; siguri në ushqim, në të ushqyerit dhe ndihmë në ushqim; strehim, dhe shërbime shëndetësore.

1 Vlerësimi i situatës urgjente

Kur planifikohet, është shumë me rëndësi se a ka numër të mjaftueshëm të vullnetarëve dhe të punësuarve që do të mund të zbatohen vlerësimi i gjendjes urgjente, që patjetër duhet të planifikohet dhe organizohet mirë nëse dëshirojmë që të jetë efektive. Në të shumtën e rasteve, menjëherë pas situatës urgjente, duhet të zbatohet vlerësim gjithëpërfshirës, që vazhdimisht duhet të ripërtihet me informacione gjatë ndërmarrjes së përgjigjes gjatë katastrofave dhe fazave për rimëkëmbje nga katastrofat.

Gjithashtu, është patjetër të sigurohet, të punësuarit dhe vullnetarët të trajnohen në mënyrë adekuate, me qëllim që të përdoren kriteret, standardet dhe treguesit e përbashkët gjatë vlerësimit. Në rrethana ideale, vlerësimin urgjent të dëmit dhe nevojat duhet ta bëjnë vullnetarët lokal në fushat të cilat janë të nënshtruara në katastrofa. Për këtë qëllim duhet të përdoret Udhëzimi për kryerjen e vlerësimit gjatë situatave urgjente dhe Fusha Standarde të Federatës Ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, të cilat janë të kapshme në FedNet.

Kur planifikohet vlerësimi i situatës urgjente në nivel lokal, komunal apo rajonal, është patjetër të identifikohen gjërat në vijim:

- Kush është përgjegjës për vlerësimin dhe kur do të bëhet (p.sh. menjëherë, pas tre ditësh, pas dy javësh, etj)? Ekipet për vlerësim duhet të jenë të përbëra nga persona me profil të ndryshëm dhe të ketë specialistë të sektorëve të ndryshëm.
- Çfarë informacione janë të nevojshme në çdo fazë të situatës urgjente?
- Si/ku do të formohen dhe trajnohen ekipet për përgjigje?
- Çfarë standarde përdoren që të matet shkalla e seriozitetit të situatës urgjente?
- Cilat elemente janë të inkorporuara në vlerësim që të sigurohet ripërtirja urgjente?
- Si do të caktohet ndikimi i ndihmës humanitare?
- Si do të kyçen në të gjithë procesin bashkësitë të cilat janë të dobishme për ndihmën?

Mbani mend! Programet do të jenë efektive dhe reale nëse bëhet vlerësim i mirë dhe i qëndrueshëm.

2 Vazhdimësi në operacione gjatë situatës urgjente

Katastrofa mundet drejtpërsdrejti ta rrezikojë aftësinë e shoqatës nacionale për të funksionuar (p.sh. nëse dëmtohet qendra apo kapacitetet tjera, nëse vjen deri në vdekjen e personave kyç në shoqatën nacionale etj). Për këtë me rëndësi është që të bëhet plan për sigurimin e vazhdimësisë së operacioneve, edhe nëse kjo nuk është aktivitet sektorial. Është shumë me rëndësi të merren parasysh elementet që vijojnë:

- Zgjedhje dhe zbatim të hapësirës dhe lokalitetit ndihmës që të sigurohet vazhdimësia e aktiviteteve më të rëndësishme.
- Aktivizimi i këtij lokaliteti dhe/apo shtabi të menaxhimit me kriza në nivel komunal apo nacional të shoqatës nacionale apo në nivel të delegacioneve të Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe.
- Dërgim të të punësuarve dhe vullnetarëve të lokaliteteve tjera.
- Sigurimi i logjistikës, IT dhe përkrahjes telekomunikative për qëllime kohore nëpërmjet përdorimit të mjeteve jo standarde apo alternative.

Këtu duhet të merret parasysh ndikimi potencial i shërbimeve të tjera të Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe siç janë programet shëndetësore, dhurimi i gjakut, aktivitetet sociale, etj. – të gjithë këto mund të jenë të rrezikuara në rast të katastrofës. Ndonjëherë, këto shërbime ndoshta do të duhet të suspendohen, që t'i jepet përparësi aktiviteteve për përgjigje në katastrofa; ndonjëherë, këto shërbime do të jenë bile edhe më prioritare se sa në rrethana normale.

3 Shpëtim dhe ndihmë mjekësore

Situatat urgjente dhe katastrofat më të mëdhaja shpesh herë rezultojnë me lëndime dhe vdekje të njerëzve. Pa dallim se a është drejtuar në nivel nacional, rajonal apo global, plani duhet t'i përmbajë informacionet që vijojnë:

- Çfarë lloji të lëndimeve dhe nevojave mjekësore mund të rezultojnë nga skenari të cilat janë të cekura në plan?
- A është i kyçur Kryqi i kuq / Gjysmëhënës e kuqe në operacionet për kërkim dhe shpëtim, dhe kush është përgjegjës për organizimin e këtyre aktiviteteve?
- Si do të veprohet me gjërat pas vdekjes?
- Kush e organizon ndihmën e parë, ndihmën e shpejtë të përkohshme, evakuimin mjekësor dhe hospitalizimin?
- Cilat sisteme për regjistrim dhe shpërndarje do të përdoren?

4 Shërbime shëndetësore

Pyetjet siç janë qasja në ujë të sigurtë, kushte të kënaqshme sanitare në strehimore dhe ushqim adekuat ndihmojnë të ndalohet paraqitja e sëmundjeve. Këto çështje duhet të diskutohen dhe elaborohen para fillimit të programeve shëndetësore. Pyetjet vijuese lidhur me gjendjen shëndetësore dhe të ushqyerit duhet të merren parasysh gjatë planifikimit të përgjigjes gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente në nivel nacional, rajonal apo global:

- Kush është përgjegjës për çështjet shëndetësore dhe të ushqyerit për popullatën e goditur?
- Në çfarë gjendje është sistemi lokal shëndetësor dhe si funksionon gjatë situatës urgjente?
- Ku mund të bëhet vaksinimi kundër sëmundjeve infektuese (p.sh. Lia)?
- Cilat janë nevojat për të ushqyerit plotësues (p.sh. për fëmijë, gra shtatzëna, lehona etj). Ose çfarë programe tjera speciale për të ushqyer mund të jenë të nevojshme?
- Cilat organizata qeveritare apo joqeveritare janë përgjegjëse për kujdesin shëndetësor, preventivën e sëmundjeve dhe fushatave për shëndet publik? Çfarë roli luan shoqata nacionale në këtë plan?
- A është mbrojtja shëndetësore / të ushqyerit ndryshe në periudhën e dimrit? Në cilën mënyrë? Çfarë masa speciale duhet të merren parasysh gjatë situatës urgjente në periudhën e dimrit?
- Si do të zgjidhet problemi me numër shumë të madh të pacientëve? Si do të ndikojë problemi i kujdesit shëndetësor dhe sistemit shëndetësor gjatë kohës dhe pas mbarimit të situatës urgjente?
- Çfarë masa duhet të ndërmerren për grupe të ndryshme të popullatës (p.sh. fëmijë, gra shtatzëna etj)?
- Çfarë medikamente dhe pajisje mjekësore janë në dispozicion? Cilat mjete plotësuese mund të jenë të nevojshme dhe në çfarë sasi?
- A ka në dispozicion kapacitete adekuate për klasifikim? Nëse nuk ka, çka duhet të bëhet?

5 Ujë, sanim dhe promovim të higjienës

Gjatë situatës urgjente, shpesh herë mungon ujë i sigurtë për pije, kapacitete adekuate sanitare dhe mjete për higjienë – të gjitha këto gjëra i bëjnë njerëzit e nënshtruar në sëmundje apo vdekje si rezultat i sëmundjeve lidhur me ujë dhe sanim. Për shkak se njerëzit mund të qëndrojnë më shumë pa ushqim se sa pa ujë, prioritet më i madh është që të sigurohet sasi adekuate e ujit të pastërt për pije gjatë situatës urgjente.

Sanitacioni dhe promovimi i higjienës gjithashtu luajnë rol të rëndësishëm në uljen e rreziqeve shëndetësore. Masat të cilat duhet të ndërmerren në këtë plan janë: pastrimi i fekaleve dhe mbeturinave; kontrolli i insekteve dhe dëmtuesve; futje të praktikave të sigurta higjienike, drenazhë të lokacioneve; dhe menaxhim i ujit dhe mbeturinave. Plani gjithashtu duhet të përmbajë dispozita për furnizim

dhe shpërndarje të ujit, promovim të higjienës dhe sanimit gjatë situatës urgjente.

Për ujë, duhet të përmenden të dhënat që vijojnë:

- Cili është burimi momental i ujit dhe cilët janë përdoruesit momental?
- Çfarë kapacitete teknike janë në dispozicion?
- A ekziston sistem për furnizim me ujë dhe nëse ekziston, a është uji afër në vendbanimet e njerëzve?
- A nevojitet trajtim i ujit? A është e mundur? Çfarë lloj trajtimi nevojitet?
- Çfarë pajisje do të nevojitet dhe a ka nevojë për rezervoare me ujë (nëse nuk ka burime lokale për furnizim me ujë)?

Për sanim, duhet të përmenden të dhënat që vijojnë:

- Si praktikohet shkuarja në toalet?
- A janë të njoftuar njerëzit për ndërtimin dhe përdorimin e toaleteve?
- A duhet të zbatohen programe për trajnim për sanim?

Për promovimin e higjienës, duhet të përmenden të dhënat që vijojnë:

- Cilat janë besimet dhe praktikat tradicionale lidhur me grumbullimin, renditjen dhe përdorimin e ujit?
- A kanë njerëzit mjaftë bidona për ujë?
- Cilat janë besimet dhe praktikat momentale (mes cilave edhe praktikat lidhur me secilën gjini në veçanti) në bazë të hudhjes së nevojës?
- A i lajnë duart njerëzit kur ka nevojë (p.sh. pasi të kryejnë nevojën dhe para përgatitjes së ushqimit për familjen)?

6 Ushqim dhe të ushqyerit

Sigurimi i ushqimit ka për qëllim të kënaqen nevojat me ushqim për popullatën e goditur gjatë situatës urgjente. Plani për përgatitje duhet të përmbajë informacione në bazë të asaj se si do të sigurohet ushqim gjatë situatës urgjente varësisht nga vëllimi dhe intensiteti i kësaj gjendje: gjatë kohës së fazës planifikuese, duhet të përgjigjen pyetjet që vijojnë, varësisht nga konteksti (nacional, rajonal apo global):

- Kush është përgjegjës për vlerësimin e nevojave për ushqim dhe koordinim të çështjeve lidhur me ushqimin gjatë operacioneve për përgjigje gjatë katastrofës?
- Çfarë ushqimi është në dispozicion në nivel lokal, në rajon dhe në vend? Cilat janë kapacitetet dhe çmimet në tregjet lokale?

- Për cilat prodhime ushqimore tradicionale ekziston mundësi se mund të mungojnë?
- Nga cilat prodhime duhet të përbëhet shporta ushqimore?
- Sa nevoja kalorike ekzistojnë në rrethe të ndryshme klimatike (p.sh. në vende të ftohta, malore)?
- Cilat nevoja themelore duhet të kënaqen tek fëmijët e vegjël?
- Çfarë sisteme shpërndarëse të ushqimit përdoren në mënyrë lokale, rajonale dhe në vend?
- Si mundet këto sisteme shpërndarëse të ushqimit të përdoren gjatë situatës urgjente?
- A do të furnizohet gjithashtu me ushqim edhe popullata që nuk është goditur e që jeton afër vendit të goditur? (Kjo çështje është aktuale në kushte kur popullata e pa goditur gjithashtu është shumë e mjeruar, bile edhe në rrethana normale).
- Kush është përgjegjës për komunikime me qeverinë dhe donatorët ndërkombëtarë për ushqim (p.sh. Programi Botëror për Ushqim), OJQ dhe agjenci tjera?
- Çfarë kapacitete për skladim të ushqimit nevojiten e çfarë kapacitete për ushqim janë të kapshme?

7 Ndhimja humanitare

Plani duhet të përmbajë informacione në detaje se si do të plotësohen nevojat urgjente në bazë të strehimores, ujit dhe ushqimit. Zakonisht në këtë plan duhet të përfshihen prodhime siç janë: sapuni, bataniet, pajisjet për kuzhinë, enët për ujë dhe fijet e shkrepës. Për shkak se situatat mund të lëvizin, lista e prodhimeve më të nevojshme duhet të përbëhet në bazë të nevojave të parashikuara të popullatës e cila mund të jetë e goditur nga situata urgjente – duke marrë parasysh dallimet kulturore aty ku është e nevojshme. Plani nacional, rajonal apo global duhet t'i marrin parasysh pyetjet që vijojnë:

- Cilat prodhime nevojiten dhe cilat prej tyre janë të kapshme? Kush do të jetë përgjegjës për bisedime dhe marrëveshje me furnizuesit për këto prodhime?
- Deri në cilën shkallë tregu lokal dhe organizatat mund të ballafaqohen me shpërndarjen e mallërave të tilla? Si mund të përforcohen këto mekanizma me qëllim që të luajnë rol më të rëndësishëm në aktivitetet për sigurimin e ndihmës humanitare?
- Çfarë janë kapacitetet lokale për shpërndarje dhe a janë të nevojshme kapacitetet plotësuese për këtë qëllim?
- Sa janë rezervat me batanie, bidona për ujë, lëndë djegëse për përgatitjen e ushqimit, shporetë, pajisje për kuzhinë, rroba dhe prodhime tjera esenciale joushqimore?
- Çfarë mekanizma keni zbatuar për sigurimin e kahjeve, regjistrimit dhe shpërndarjen e ndihmës?
- Kush është përgjegjës për menaxhim me ndihma humanitare?

- Kush është përgjegjës për zbatimin e vlerësimit të nevojave?
- Si do të zbatohet procesi i monitorimit dhe evaluimit?
- Si do të koordinohet kualiteti, sasitë dhe përfshirja me agjenci tjera?

8 Strehimore

Në disa raste, sigurimi i strehimores urgjente është i nevojshëm për njerëzit shtëpitë e të cilëve janë të shkatërruara apo nuk janë të sigurta për jetesë. Për këtë qëllim ndoshta do të nevojitet të bëhen riparime nëpër shtëpitë (duke kështu sigurimin e mjeteve dhe materialeve adekuate të cilat përdoren në mënyrë lokale), shpërndarja e tendave për strehim të përkohshëm, apo strehim të personave pa shtëpi në ndërtesa publike siç janë shkollat. Në planin e sigurimit të strehimores gjatë planifikimit të përgjigjes gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente duhet të merren parasysh pyetjet që vijojnë në nivel nacional, rajonal apo global:

- Cila është politika qeveritare në bazë të sigurimit të strehimores për popullatën e goditur nga katastrofa? Cili trup qeveritar apo agjenci është përgjegjës për aktivitete lidhur me sigurimin e strehimores?
- Cilat organizata qeveritare, lokale dhe ndërkombëtare janë aktive në planin e sigurimit të strehimores?
- Kush është përgjegjës për menaxhim dhe vlerësim të nevojave lidhur me sigurimin e strehimores?
- A nevojiten tendat, materiale për ndërtimtari dhe mbulesa prej plastmase?
- A janë caktuar lokalitete apo objekte për strehimin e popullatës së goditur nga katastrofa e madhe?
- Si ndahen lokalitetet e tilla? A ka vështirësi lidhur me posedimin e truallit për lokalitete të tilla? Cilat probleme potenciale mund të paraqiten në bashkësinë lokale?
- Çfarë vështirësi mund të paraqiten në kohëra të ndryshme vjetore (dimër, verë, vjeshtë etj)?
- Çfarë lloj ndihme do të nevojitet për personat të cilët janë të strehuar apo të vendosur nëpër shtëpitë e faretit apo miqve (ndihmë në ushqim, nxemje, pajisje për gatim, preparate higjienike, ujë dhe sanim)?
- A është zgjedhje më e mirë që njerëzve t'ju ndihmohet me mjete financiare me atë çka njerëzit do të kenë më shumë zgjidhje?
- Cili material ndërtimor tradicional është i pranishëm tek ne? A e dëmton blerja dhe përdorimi i materialit ndërtimor tradicional mjedisin jetësor dhe nëse është i tillë rasti, cili material mund të përdoret si kompensim?
- Mbani mend se duhet të përdoret ajo që është në dispozicion në mënyrë lokale (hulumtoni se cilat materiale i përdorin njerëzit për shtëpi dhe në cilën mënyrë mund të përmirësohet siguria e ndërtimeve).
- Cilat zgjidhje në mënyrë më të mirë i përdorin dituritë, kapacitetet dhe resurset në bashkësitë për sigurimin e strehimoreve adekuate? Si promovohen teknikat lokale për ndërtim të sigurt (p.sh. Ngritja e vetëdijes

në bashkësitë me paraqitjen e procedurave kyçe të sigurta gjatë ndërtimit, siç janë hudhja e themeleve adekuate, përforcimi i ndërtimeve etj.)?

- Si bëhet evaluimi i rreziqeve të ndërtimeve ekzistuese? Si mund të vlerësohet stabiliteti i ndërtimeve pasi të ndodhë katastrofa? Si mund të sigurohet planifikim adekuat i ndërtimeve me qëllim që të minimizohen rreziqet? Çfarë masa për lehtësim të gjendjeve mund të ndërmerren që të ulen rreziqet e ardhshme në bazë të meremetimit të shtëpive të dëmtuara?
- Si mundet ndihma teknike për rikonstruim të përdoret për të kthyer popullatën nëpër shtëpitë e tyre, kur do të ketë mundësi? Mbani mend, në të shumtën e rasteve, familjet menjëherë do të dëshirojnë të kthehen në shtëpitë e dëmtuara apo të shkatërruara. Как може техничката помош за реконструкција да се искори

9 Zbatimi i lidhjeve familjare

Një ndër detyrat primare në planin e përkrahjes sociale humanitare është që menjëherë të sigurohet hetim i shpejtë për personat e zhdukur që të bashkohen familjet e ndara. Familja është njësia themelore sociale në të shumtën e shoqërive dhe luan rol të rëndësishëm në plotësimin e nevojave dhe zgjedhjen e problemeve në bashkësi. Shoqatat nacionale të cilat janë të obliguara për realizimin e lidhjeve familjare duhet të marrin parasysh pyetjet që vijojnë kur ta bëjnë planifikimin në nivel nacional:

- Kush është përgjegjës për udhëheqjen e aktiviteteve për kërkim dhe bashkim të familjeve dhe cilët të punësuar dhe vullnetarë do të kyçen në aktivitete?
- A janë të kyçur në aktivitete Komiteti ndërkombëtar i Kryqit të kuq dhe shoqatës nacionale?
- Për sa familje do të ketë nevojë strehim të përkohshëm?
- Cilat janë normat kulturore të cilat mund t'i pengojnë aktivitetet për bashkimin e familjeve (p.sh. tabu ndaj fotografimit)?
- Cilat metoda dhe qasje do të përdoren për zbatimin e këtyre aktiviteteve?
- Cilat metoda komunikuese do të përdoren për bashkimin e familjeve të ndara?
- Cilat agjenci dhe njësi qeveritare janë përgjegjëse për këto operacione? Cili nivel i koordinimit nevojitet?
- Në cilën fazë të përgjigjes duhet të fillohen operacionet për kërkimin e njerëzve (kjo zakonisht fillon në periudhën prej 24 deri 48 orë pas katastrofës, për shkak se shumë familje në këtë periudhë kanë sukses të bien në kontakt me familjarët e tyre)?
- Në cilën mënyrë do të informohet popullata e goditur për këtë shërbim?

10 Mbrojtje dhe siguri

Planet për përgatitje duhet të përmbajnë informacione në bazë të asaj se kush është përgjegjës për mbrojtjen dhe sigurinë e popullatës së goditur nga katastrofa. Kjo zakonisht është përgjegjësi e qeverisë së shtetit, edhe pse mund të kyçen edhe të tjerë. Plani gjithashtu duhet t'i identifikojë aksionet të cilat duhet të ndërmerren që të sigurohet siguria e të punësuarve dhe vullnetarëve të Kryqit të kuq të cilët janë të kyçur në aktivitetet për përgjigje në katastrofa.

Siguria është çështje komplekse dhe Federata ndërkombëtare e shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe ka përgaditur udhëzim adekuat që është i kapshëm në FedNet4. Për Federatën ndërkombëtare, siguria në teren – duke kyçur edhe kodet institucionale dhe personale për sjellje, bazohen në shtatë faktorë. Dy faktorët e parë janë të vetmet në Kryqin e kuq / Gjysmëhënën e kuqe dhe kanë të bëjnë me: (1) pranim (politike dhe operative) të parimeve themelore të cilat janë udhëheqës në punën e Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe, dhe (2) identifikim, nëpërmjet përdorimit të njohur të emblemes.

- Pranim
- Identifikim
- Informim
- Rregullore
- Sjellje personale
- Komunikime
- Mbrojtje

11 Logjistikë dhe transport

Operacionet për sigurimin e përgjigjes gjatë katastrofave dhe situatave urgjente shpesh herë obligojnë transportin e personelit të numëruar, dhe sasi të mëdha të ndihmës humanitare dhe pajisjes deri në vendin ku ka ndodhur fatkeqësia. Për shkak të kësaj çështje lidhur me logjistikë dhe transport janë me rëndësi të posaçme për përgjigje të suksesshme në katastrofë: Aspektet në vijim lidhur me logjistikë dhe transport duhet të merren parasysh gjatë planifikimit në nivel nacional, rajonal dhe global:

- Cilat janë rrugët dhe alternativat kryesore për dorëzimin e ndihmës në fushat dhe tek popullata që parashikohen se mund të jenë të goditura nga katastrofat?
- A janë përgatitur marrëveshje me shpërndarësit që të përshpejtohet procesi i furnizimeve?
- Ku janë të locuara portet dhe aeroportet e mundshme, si dhe informacionet relevante për kapacitetet dhe procedurat e këtyre lokaliteteve?
- Cilat janë lokalitetet më adekuate për shpërndarjen e ndihmës?

- A janë theksuar modalitete të transportit (e.g. komunikacion tokësorë, hekurudhorë, aeroplan etj) dhe çështje lidhur me posedimin dhe çmimet?
- Çfarë mundësi ekzistojnë për skladimin e karburanteve, servisimin e automjeteve, me përkufizime të theksuara qartë?
- Niveli i bashkëpunimit me agjenci qeveritare apo ministri përgjegjëse për procedurë doganore të mallërave që arrijnë në vend? A kanë arritur marrëveshje me strukturat qeveritare që të sigurohen kushte për sjelljen e ndihmave humanitare?
- Cilat pjesë rezervë mund të jenë të nevojshme për automjetet? A janë bërë marrëveshje preliminare për sigurimin e këtyre pjesëve?
- Si mund të jetë ndikimi i punës logjistike?
- A janë definuar nevojat dhe a është zbatuar trajnim për personelin dhe strukturat për punë logjistike në rast të katastrofave?

12 Teknologji dhe telekomunikacion informativ

Komunikimet e vazhdueshme dhe efektive mes komponenteve të ndryshme në Lëvizje janë me rëndësi esenciale për suksesin e cilit do operacion në situatë urgjente. Tek radio komunikimet, me rëndësi esenciale është në planin për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente të theksohen radio frekuencat relevante. Në planin gjithashtu duhet të theksohet se kush do të menaxhojë, mirëmbajë dhe kontrollojë qasjen në pajisjet e radios. Gjërat në vijim duhet të merren parasysh kur planifikohet në nivel nacional, rajonal apo global:

- Çfarë janë kapacitetet e shoqatës nacionale (lidhshmëri, lloje të telekomunikacionit, mbulim etj)?
- Si është legjislative nacionale në krahasim me përdorimin e llojeve të ndryshme të teknologjisë informative dhe pajisjes telekomunikative – posaçërisht gjatë situatave urgjente?
- Çfarë pajisje komunikative parashikoni që do të jetë e nevojshme (siç janë radio stacionet, telefonat satelitorë, telefonat celularë dhe telefonia fikse)?
- A janë identifikuar dhe nënshkruar radio frekuencat dhe kanalet?

13 komunikacione dhe lajmërimi

As nga afër nuk mund të theksohet se sa janë të rëndësishme komunikimet. Që të mundet Federata ndërkombëtare e shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe të veprojnë si pikë fokale për sigurimin e informacioneve për katastrofën, shoqatat nacionale duhet menjëherë ta informojnë për çfarë do katastrofe më të madhe, vëllimin e katastrofës dhe dëmi i shkaktuar dhe çfarë aktivitete të drejtpërdrejta janë ndërmarrë për mbulimin e pasojave. Sigurimi në kohë i informacioneve për Sistemin për informim DMIS posaçërisht është i rëndësishëm që të alarmohet bashkësia më e gjërë për katastrofën e ndodhur, posaçërisht nëse shkalla e katastrofës obligon sigurimin e ndihmës humanitare.

Njësia për hartim në Federatën ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmnëhënës së kuqe mundet menjëherë të përgatisë harta të cilat mund të ndihmojnë në planifikimin e përgjigjes adekuate për katastrofën dhe situatën urgjente. Kjo mund të sigurohet nëpërmjet ndarjes së informacioneve nëpër sistemin DMIS gjegjësisht, ndarjen e informacioneve nëpërmjet menaxhuesve për katastrofa të shoqatave nacionale. Sistemet gjeografike informative për hartim (GIS) dhe fotografitë satelitore gjithashtu janë resurse të cilat duhet të hulumtohen nëpërmjet qeverive, bashksisë akademike dhe shkencore. Çështjet të cilat duhet të merren parasysh gjatë formulimit të planeve nacionale, rajonale apo globale janë:

- Si do të jetë strategjia për informimin e opinionit?
- A mund të ballafaqohet kuantumi momental i të punësuarve me interesin e mundshëm të gazetarëve dhe kërkesave të parapara për informacione në media, apo të angazhohet personeli plotësues?
- A mund kuantumi momental i të punësuarve të sigurojë input në kohë për buletinet informative, raportet operative dhe apelet për donatorë apo duhet të angazhohet personel plotësues për përgatitjen e raportit?
- Në cilën mënyrë duhet të koordinohen marrëdhëniet me publikun?
- Cila do të jetë strategjia informative për popullatën qëllimore? Në kuadër të Lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmnëhënës së kuqe? Për donatorë? Për agjenci tjera?

14 Monitorim dhe evaluim

Pasi të sigurohet ndihma initiale për popullatën e goditur, është shumë me rëndësi të sigurohet ndihma që të arrijë tek përdoruesit në mënyrën në të cilën është planifikuar ajo, dhe se është realizuar ndikimi i paraparë dhe se nuk janë lënë anash nevoja të caktuara për popullatën. Implementimi i planit për monitorim dhe evaluim – për përgjigje të tërësishme në katastrofë, si dhe për secilin nga programet individualisht – paraqet pjesë integrale të përgjigjes në katastrofa. Gjërat në vijim duhet të merren parasysh kur përgatiten planet për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente në nivel nacional, rajonal dhe global:

- Çfarë niveli i monitorimit dhe evaluimit do të nevojitet?
- Në cilat fusha do të nevojitet monitorim në secilin sektor individualisht?
- Cilat mjete do të jenë të patjetërsueshme për zbatimin e monitorimit dhe evaluimit (p.sh. formulare, lista për kontrollim, formate për lajmërim etj)?
- Si do të adresohen pyetjet të cilat do të dalin nga mendimet e monitorimit dhe evaluimit?
- Si do të identifikohet dhe trajnohet numri i duhur i vullnetarëve dhe të punësuarve të cilët nevojiten për këtë qëllim?
- Si do të jenë të kyçur përdoruesit në procesin e përgjithshëm të monitorimit dhe evaluimit?

Kreu 3

Koordinim i brendshëm dhe i jashtëm

Koordinimi është kyç për përgjigje të suksesshme gjatë katastrofave, dhe është me rëndësi të posaçme për sigurimin e shpërndarjes së reasurseve në kohë dhe në mënyrë adekuate. Aktivitetet koordinative mund të zhvillohen në nivele dhe forma të ndryshme. Koordinimi i mirë është me rëndësi të posaçme për kombinim efektiv dhe efikas të resurseve, me qëllim që të arrihet më shpejtë tek të goditurit nga katastrofa. Koordinimi kontribuon për bashkëpunim më të mirë, e ulë nivelin e dyfishimit të orvatjeve dhe ndihmon për sigurimin e organizimit të mirë të operacioneve. Për Kryqin e kuq / Gjysmëhënën e kuqe, dy fushat kryesore të koordinimit janë koordinimi i brendshëm (në kuadër të Lëvizjes) dhe koordinimi i jashtëm.

Parimet dhe rregullat e Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe për ndihmën humanitare gjatë katastrofave i përmbajnë rregullat dhe përgjegjësitë në bazë të koordinimit. Punët kryesore të cilat duhet të merren parasysh janë:

- Kryqi i kuq / Gjysmëhëna e kuqe në nivel nacional dhe ndërkombëtar – duhet të mundohet gjatë operacioneve ta kesë parasysh ndihmën e cila sigurohet nga ana e organizatave tjera nacionale dhe ndërkombëtare.
- Shoqatat nacionale ndoshta ndonjëherë do të duhet të përgjigjen në katastrofat të cilat i kalojnë kapacitetet e tyre, prandaj duhet të bëhen përgatitje për marrjen dhe menaxhimin e ndihmës humanitare të cilën e siguron Federata ndërkombëtare e shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe.
- Shoqatat nacionale duhet të mundohen të nënshkruajnë marrëveshje për përkrahje reciproke në rast të katastrofave, posaçërisht me shoqatat nacionale të vendeve fqinje.
- Federata ndërkombëtare e shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe duhet të orvatet të nënshkruajë marrëveshje për ndihmë gjatë katastrofave me shoqatat nacionale të vendeve të goditura nga katastrofat, me qëllim që të përparojnë aktivitetet nacionale për përgatitje gjatë katastrofave.

Koordinimi i brendshëm

Koordinimi në Lëvizje

Përgjigjet kyçe për koordinim mes komponenteve të Lëvizjes gjatë katastrofave ndërkombëtare rregullohen në Marrëveshjen e Seviljës dhe Masdat plotësuesem në Kushtetutën e Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe dhe në Parimet dhe rregullat e Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe për ndihmë humanitare gjatë katastrofave. Është shumë me rëndësi të merret parasysh roli i secilit nga komponentat e Lëvizjes gjatë planifikimit të situatave urgjente për skenare të ndryshme të katastrofave dhe të punohet në pajtueshmëri me politikën relevante dhe / apo marrëveshjet që të sigurohet koordinim i mirë, ndërmarrje të përgjegjësisë të veta dhe aksionit adekuat.

Edhe nëse cilat do dy katastrofa të ndryshme as nga afër nuk do të akumulojnë nivel të njëjtë të përkrahjes ndërkombëtare, prapë se prapë ekzistojnë skenare të përbashkëta të cilat obligojnë zbatimin e mekanizmave specifike koordinative për menaxhimin e përkrahjes ndërkombëtare. Dy skenaret e përshkruara më poshtë gjithashtu janë relevante për katastrofat rajonale (tejkufitare):

1. Katastrofa natyrore ndodh në fushë pa konflikt dhe me të nuk mund të ballafaqohet shoqata nacionale e goditur. Parimet dhe rregullat e Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe për ndihmë humanitare gjatë katastrofave janë dokumenti themelor i cili duhet të përcjellet që të sigurohet përgjigje efektive nga ana e Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe dhe anëtarëve të saj. Marrëveshja e Seviljës dhe Masat plotësuese duhet të përcillen në krahasim me përgjegjësitë koordinuese.
2. Katastrofa natyrore ndodh në fushë me konflikt ku vepron dhe është operativ Komiteti ndërkombëtar i Kryqit të kuq. Marrëveshja nga Sevilja dhe Masat plotësuese duhet të përcillen që të vërtetohet se kush është përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve për sigurimin e ndihmës gjatë katastrofave dhe çfarë aksioni duhet të ndërmerret në bazë të koordinimit me partnerë tjerë të Lëvizjes. Aty ku Federata ndërkombëtare e shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe ka përgjegjësi të veta, atëherë dokument udhëheqës janë Parimet dhe rregullat e Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe për ndihmën humanitare gjatë katastrofave.

Disa aktivitete koordinuese mund të zbatohen në dy skenaret dhe duhet të kyçen në planin për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente, si dhe në trajnim, me qëllim që të sigurohet përgjigje më e përshtatshme e Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe.

- Mbledhjet koordinuese – Plan për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta me partnerët e Lëvizjes me qëllim që të vërtetohen aktivitetet dhe rolet;
- Hartimi i resurseve të Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe – identifikimi i resurseve dhe kompetencave të Lëvizjes;
- Menaxhim informativ – shpërndarja e informacioneve për ndikimin e katastrofës, vlerësimi dhe nevojave nëpërmjet inputit në sistemin informativ për menaxhim me katastrofa (DMIS);
- Mjetet e komunikimit – plani për informim të vazhdueshëm dhe rrjedhshmëri të komunikimeve;
- Korniza për Koordinim në Lëvizje – Plan për koordinim strategjik dhe operativ;
- Marrëveshje me partnerë – identifikimi i marrëveshjeve ekzistuese. Vërtetim i nevojave nga marrëveshjet plotësuese që të kënaqen nevojat ekzistuese;
- Marrëveshje për status juridik – rregullim i statusit juridik të shoqatave nacionale dhe delegacionit të Federatës ndërkombëtare në vend.
- Koordinues të Lëvizjes – Mjete operative siç janë FACT, ERU, DREF dhe DMIS.
- Trajnim dhe orientim – Të mundësohet individët të reagojnë në mënyrë adekuate në situatën e dhënë në pajtueshmëri me rolet koordinative.

Pikat e lartëpërmendura janë të sqaruara në mënyrë plotësuese në Doracak – *Koordinim i Marrëveshjes ndërkombëtare gjatë katastrofave, 2007.*

Koordinim i jashtëm

Gjatë përgatitjes së planit gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente, patjetër të merren parasysh kapacitetet dhe resurset e institucioneve dhe organizatave të cilat nuk janë pjesë e Lëvizjes. Prania dhe përgjegjësitë e tyre në sektorë të caktuar apo fusha gjeografike janë shumë relevante për planin gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente.

Këto agjenci apo institucione mund të kategorizohen në tre grupe më të gjëra, në pajtueshmëri me misionin, rolin dhe fushën e tyre të përgjegjësisë:

1. Institucione nacionale qeveritare (mbrojtja civile, ministria e shëndetësisë, agjenci për menaxhim me katastrofa, armata etj.);
2. Organizata nacionale apo ndërkombëtare joqeveritare (CARE, Oxfam, MSF etj.); dhe
3. Organizata për bashkëpunim multilateral dhe / apo bilateral (agjenci të Kombeve të bashkuara, IOM, ECHO, ASEAN, USAID, DFID, lidhje ushtarake ndërkombëtare / rajonale). Mbani mend se Zyra e Kombeve të bashkuara për Koordinim të Punës Humanitare (OCHA) është organizata përgjegjëse për koordinimin e situatave të tilla e Kombeve të bashkuara.

Nuk ka nevojë të zbatohet analizë për secilin grup, por duhet që secili prej tyre të mund të luajë rol të rëndësishëm gjatë përgjigjes në katastrofa. Tabela në vijim jep pasqyrë të institucioneve dhe organizatave të cilat duhet të merren parasysh.

Lloji i institucionit	Shembuj
Agjenci qeveritare për përgjigje dhe koordinim (në vendin e goditur dhe vendet tjera)	Mbrojtja civile, agjenci për mbrojtje dhe shpëtim. Shumica e vendeve kanë agjenci nacionale për menaxhim me kriza, apo drejtori për mbrojtje dhe shpëtim apo trupa tjerë në të cilat Kryqi i kuq duhet të jetë i kyçur për shkak të ndërmarrjes së aktiviteteve dhe koordinimit. Në të shumtën e rasteve edhe ushtria luan rol të rëndësishëm në raste të tilla.
Organizata humanitare dhe shpëtimtare (në vendin e goditur apo vende tjera).	Shërbimi i zjarrfikësve dhe ndihma e shpejtë, policia, ushtria, agjenci për shpëtim dhe kërkim etj.
Ministri relevante fushat përgjegjëse të të cilave kanë pika depërtuese me programet e shoqatës nacionale.	Ministria e shëndetësisë, ministria e punës dhe politikës sociale, ministria e arsimit, ministria e punëve të brendshme, ministria e mjedisit jetësor etj.
Organizata interqeveritare dhe rajonale për koordinim gjatë intervenimeve urgjente.	NATO, OSBE, ASEAN etj.
Agjenci të Kombeve të bashkuara me programe apo aktivitete në fusha prioritare apo në fusha ku Lëvizja ka histori të bashkëpunimit.	UNICEF, Programi botëror për ushqim, UNHCR, OBSH, UNDP OCHA etj.
Organizata aktive nacionale dhe joqeveritare me programe në fusha të caktuara.	Organizata joqeveritare të specializuara për shërbime shëndetësore, ushqim të sigurt, strehimore, ujë, sanim etj.
Organizata joqeveritare me misione të ngjajshme apo komplementare me ato të shoqatës nacionale, dhe me donatorë të përbashkët apo histori të bashkëpunimit të afërt.	OXFAM, Save the Children, CARITAS, CARE, MSF.
Projekte me ndikim të rëndësishëm në fusha të cilat janë prioritare në planin për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente.	Banka botërore, IADB etj.
Organizata tjera relevante publike apo private.	Organizata akademike dhe qendra hetimore.

Shiko **Aneksi 9** për identifikimin e roleve organizative.

Partnerë të Kombeve të bashkuara

Që sigurohet se resurset ndërkombëtare përdoren në mënyrë sa më të mirë të mundshme në favor të popullatës së goditur nga katastrofa. Federata ndërkombëtare e shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe duhet patjetër të angazhohet në planin e sigurimit të koordinimit ndërkombëtarë. Prej vitit 1994, Federata ndërkombëtare ka statusin e vëzhguesit të Kuvendit gjeneral të Kombeve të bashkuara.

Në nivel të terrenit, kjo do të thotë koordinim aktiv me partnerët e Kombeve të bashkuara gjatë operacioneve në katastrofa. Modeli momental i këtij plani është ekzistimi i Ekipit Ekzistues mes Agjencive (IASC) për një vend të caktuar. Këto ekipe janë të përbëra nga organizatat joqeveritare, Kryqi i kuq / Gjysmëhëna e kuqe dhe Agjencitë e KB dhe paraqesin forum ku këto organizata takohen që të merren vesh në bazë të ndërmarrjes së aktiviteteve për përgatitje dhe përgjigje gjatë katastrofave.

Kombet e bashkuara luajnë rol të madh në koordinimin e përgjigjes ndërkombëtare gjatë situatave urgjente. Për këtë, është shumë me rëndësi që Kryqi i kuq / Gjysmëhëna e kuqe, duke marrë parasysh mandatin specifik dhe Parimet e Lëvizjes.

Është shumë me rëndësi të dihet se si funksionojnë dhe punojnë partnerët e Kombeve të bashkuara, gjatë implementimit në planin për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente në nivel lokal, rajonal dhe global. Në rrethana ideale, shoqatat nacionale dhe delegacionet e Federatës ndërkombëtare duhet të kenë realizuar marrëdhënie pune me Agjencitë e Kombeve të bashkuara apo bile të jenë të njoftuar me vëllimin e punës së tyre. Është me rëndësi të përmendet se Federata ndërkombëtare ka nënshkruar numër të madh të marrëveshjeve individuale me agjencitë e Kombeve të bashkuara në sktorë të ndryshëm të përgjigjes humanitare. Ato janë paraqitur më poshtë në këtë kaptinë në mënyrë detale.

Marrëveshje të përgatitura më herët

Sekretariati i Federatës ndërkombëtare punon në lidhje të ngushtë me shoqatat nacionale dhe Komitetin ndërkombëtar të Kryqit të kuq; Gjithashtu kjo organizatë, në emër të anëtarëve të vet bashkëpunon me shumë organizata, me qëllim që të zbatohet në mënyrë më efikase puna e Federatës ndërkombëtare. Për shembull, sekretariati i Federatës ndërkombëtare ka përgatitur marrëveshje pune me numër të madh të partnerëve ndërkombëtarë, me fokusim në prioritetet e vërtetuara në Strategjinë 2020. Linku në vijim i prezanton marrëveshjet aktive në fuqi në kuadër të fushave kyçe në nivel rajonal dhe global:

<http://www.ifrc.org/who/agreement.asp>.

Bashkëpunimi tejkuftar

Ndonjëherë rreziqet dhe katastrofat nuk janë të kufizuara vetëm në një vend, apo ndoshta kanë ndikim në vend tjetër si rezultat i faktorëve siç janë afërsia apo lidhjet historike. Gjatë formulimit të planit për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente, me rëndësi është që të kontaktohen dhe kyçen shoqatat nacionale dhe delegacionet e Federatës ndërkombëtare të vendeve fqinje. Planet duhet të përmbajnë analizë tejkuftare për ndodhitë politike dhe ndikimi i tyre potencial në popullatë, si dhe identifikimi i situatave të caktuara mjeruese në fushat kufitare. Duhet të merren parasysh skenarë të ndryshëm (p.sh. Skenarë të mundshëm si dhe skenare më të këqija të mundshme), dhe të zbatohen trajnime simuluese që të testohet përgjigja tejkuftare.

Në raste të trazirave qytetare, me rëndësi esenciale është që të merren parasysh implikimet e sigurisë dhe të planifikohet në mënyrë adekuate për ato që të sigurohet siguria e vullnetarëve të Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe gjatë aktiviteteve kur merret përgjigja e pasojave nga katastrofa. Duhet fillimisht të zbatohen linja të qarta të komunikimit mes vendeve dhe në shoqatat nacionale, të rregulluara në plane, si dhe përshtatshmëri të telekomunikacioneve.

Koordinim rajonal dhe ndërkombëtar

Delegacionat rajonale të Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe kanë përgjegjësi që të sigurohen kontaktet me organizata relevante rajonale. Ato mund të jenë zyra rajonale të ECHO, banka rajonale zhvillimore (IADB, Banka Aziatike Zhvillimore, etj.), dhe entitete rajonale (p.sh. ASEAH, Bashkimi Afrikan, SEPRADENAS etj.). kjo duhet të bëhet si pjesë e politikës së përgjithshme koordinative që të sigurohet se janë zbatuar kontakte të cilat mund të kontaktohen kur shoqatat nacionale apo delegacionet e Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe e përgatisin planin për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente. Udhëzimi për planifikimin ndërmjet agjencive për situata urgjente është krijuar posaçërisht me qëllim që të ndihmohet në përgatitjen e planeve ndërmjet agjencive për situata urgjente dhe duhet të përdoret në procesin e planifikimit.

Një ndër mekanizmat koordinative kryesore rajonale / ndërkombëtare është “qasja në grupe”, e cila normalisht është i vërtetuar para se të ndodhin situatat urgjente, që mund të futet në praktikë gjatë operacioneve urgjente. Ai i mbulon sektorët kryesorë të përgjigjes gjatë situatave urgjente (p.sh. shëndetësinë, ujin dhe sanimin, strehimin, logjistikën etj.) dhe zbatohet në të gjithë bashkësinë humanitare.

Secili sektor e udhëheq agjencinë e caktuar sipas marrëveshjes paraprakisht të vërtetuar (p.sh. OBSH është përgjegjëse për kujdesin shëndetësor, Federata ndërkombëtare sigurimin e strehimores gjatë katastrofave natyrore etj.) – edhe pse gjatë operacionit, agjencitë udhëheqëse mund të merren vesh t’ua

dorëzojnë rolin e tyre koordinues agjencive tjera. Gjatë përgatitjes së planeve rajonale, nacionale apo globale. Shumë është me rëndësi të merret parasysh qasja në grupe me qëllim që të sigurohet angazhimi ynë në koordinimin humanitar, por të ketë kujdes të mos kompromitet mandati dhe parimet e Lëvizjes.

Koordinimi në Lëvizje duhet të jetë i pranishëm në këtë nivel gjatë krijimit të planeve për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente. Është shumë me rëndësi që përkrahja ndërkombëtare dhe rajonale të lidhen me qëllim që përkrahja të paraqesë vlerë shtesë që të mos pengohet përgjigja nacionale gjatë katastrofave.

Kreu 4

Planifikimi i implementimit dhe vëzhgimit

Me qëllim që plani për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente të jetë dinamike dhe mjet e dobishëm që mundëson sjellje të lehtë dhe adekuate të vendimeve gjatë katastrofave, është e nevojshme që të ndahet kohë dhe resurse për zbatimin e vendimeve për ngritjen e vetëdijes së popullatës, testimi nëpërmjet simulimeve dhe trajnimeve. Përgatitja e planeve nuk duhet të jetë aktivitet statik me fillim dhe mbarim të definuar, por duhet të jetë proces ciklik dhe i përhershëm i integruar në strategjitë dhe detyrat e përditshme të situatës.

Trajnim dhe njoftim me planet për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente

Procesi i planifikimit të përgjigjes gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente do të jetë efektiv nëse ata të cilët i sigurojnë këto shërbime dhe ata të cilët e pranojnë postën dijnë se çka të bëjnë dhe çka të presin para, gjatë situatës urgjente dhe pas ndodhjes së situatës urgjente. Shoqatat nacionale të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe të cilët janë të kyçur në operacionet për veprim gjatë katastrofave duhet t'i informojnë njerëzit me fushat shumë të rrezikuara për planet për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente dhe të gjitha çështjet tjera lidhur me veprimin në rrethana të tilla (shiko ankesi 10), si dhe ta edukojnë popullatën për masat elementare të cilat duhet t'i ndërmarrin për uljen e ndikimit të katastrofës potenciale.

Plani për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente duhet:

- Të përmbajë masa për përgatitje gjatë katastrofave të cilat duhet t'i ndërmarrë secili individ si dhe të gjitha bashkësitë.
- Të theksojë se në cilën mënyrë do të lajmërohet popullata lokale në rast të situatës urgjente, dhe mënyrat në të cilat njerëzit do të mund të vullnetarizojnë në procesin e sigurimit të përkrahjes së përgjigjes gjatë katastrofave.
- Të ketë njohuri për situatat lokale dhe ato informacione të jenë të përmbajtura në planet për përgjigje gjatë katastrofave. (në këtë mënyrë Kryqi i kuq / Gjysmëhëna e kuqe në kuptimin e vërtetë do të jetë organizatë e cila e themelon punën e vet në bashkësitë lokale).

Në fund, familja, fqinjët dhe anëtarët e bashkësisë lokale janë të parët të cilët arrijnë në vendin e ngjarjes kur të ndodhë katastrofa. Për këtë, edukimi i personave jeta apo shtëpitë e të cilëve mund të jenë të shfaqur në rrezik gjatë katastrofës është komponentë thelbësore e planifikimit të përgjigjes gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente, siç është i rëndësishëm

angazhimi dhe mbajtja e vullnetarëve në Kryqin e kuq / Gjysmëhënën e kuqe. Edukimi i tillë apo ngritja e vetëdijes mund të zhvillohet në format vijuese:

Ngritja e vetëdijes publike, edukimi dhe trajnimi

Nëpërmjet programeve të llojllojshme për edukimin e publikut, personat të cilët janë në rrezik nga katastrofa potenciale, do të mund të mësojnë se çka mund të presin dhe se çka duhet të bëjnë, apo si mund të marrin pjesë në aktivitetet për sigurimin e përkrahjes gjatë situatave urgjente. Në të njëjtën kohë, ata të cilët e zbatojnë programin për edukimin e publikut gjithashtu duhet të grumbullojnë informacione kthyes nga popullata lokale në bazë të problemeve potenciale apo mangësive të cilat mund të ekzistojnë në vet planet.

Vetë bashkësitë kanë njohuri të mëdha për rreziqet e mundshme, resurset dhe kapacitetet. Është shumë me rëndësi të merret parasysh se fusha e menaxhimit të katastrofave, edukimi paraqet proces dyanësorë. Për shembull, nëse grupi nuk i kupton në tërësi procedurat për paralajmërim në bazë të planit të caktuar, atëherë ato duhet të përshtaten apo përpunohen.

Trajnim specifik për përgjigje gjatë katasrofave

Trajnimi duhet të dizajnohet për popullatën e rritur, me theks në trajnime për përgatitje gjatë katastrofave të Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe për të punësuar dhe vullnetarë. Disa prej shoqatave nacionale ofrojnë trajnim në sektorë specifik siç janë vlerësimi i dëmeve / nevojave, strehimore, ndihma humanitare, përgatitje gjatë katastrofave në bashkësi lokale, përkrahja shëndetësore gjatë situatave urgjente etj. Shumë prej mjeteve për trajnim mund të gjenden në FedeNet., në pjesën e materialeve dhe resurseve për menaxhim me katastrofa.

Kurset për trajnim gjithashtu duhet të dedikohen edhe për organizata tjera lokale të cilat me siguri do të sigurojnë shërbime të rëndësishme në rast të katastrofave, bile edhe nëse kjo nuk bën pjesë në mandatin e punës së tyre. Trajnimi i numrit të madh të personave të tillë në fusha me rrezik të lartë do të ndihmojë një pjesë të madhe të popullatës të hasë aftësi dhe informacione relevante gjatë katastrofave para dhe gjatë situatave urgjente.

Është shumë me rëndësi që të lidhet trajnimi i përgjithshëm i cili është i kapshëm në Lëvizje, me qëllim që të sigurohet qasja e koordinuar nga niveli lokal kah ai global. Për shembull, trajnimi për ekipet nacionale për përgjigje gjatë katastrofave do të mundësojë që ato të jenë përkrahje komplementare e ekipeve rajonale për përgjigje gjatë katastrofave, të cilët nga ana tjetër do të paraqesin përkrahje komplementare për iniciativa globale për përgjigje urgjente gjatë katastrofave apo për zbatimin e vlerësimit gjatë katastrofave. Me këtë sigurohet vazhdimësi dhe kuptim se si çdo njësi funksionon në sistem, dhe se si pjesë të ndryshme të sistemit për menaxhim të katastrofave formojnë një tërësi të përbashkët.

Përfundimisht, patjetër duhet të theksohet se trajnimi nuk është diçka që bëhet vetëm një herë. Me rëndësi thelëbsore është që vazhdimisht të sigurohen kurse dhe trajnime për freskimin e diturive të vullnetarëve dhe të punësuarve në shoqatat nacionale dhe delegacionet e Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe.

Trajnime dhe simulime

Mënyra e vetme që të shihet se a funksionon plan i caktuar për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente është që të provohet, evaluohet dhe revidohet nëse ka nevojë. Kjo mund të bëhet në dy mënyra:

- (1) Nëpërmjet organizimit të trajnimeve / simulimeve; dhe
- (2) Revidimi i planeve pasi të ndodhë katastrofa.

Trajnimet sigurojnë mundësi të shkëlqyeshme që të shihen anët pozitive dhe të dobëta të planit. Tek ato nuk është patjetër të kyçen të gjithë vepruesit, dhe mund të organizohen edhe vetëm personat të cilët planifikojnë dhe sjellin vendime). Kontrollimi i rezultateve mundëson të nxjerren mësimet e mësuara nga trajnimi. Pastaj këto mësimet mund të inkorporohen në planin për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente, me çka do të mundësohet që plani të përmirësohet dhe të mundësohet implementim më i mirë i operacioneve për sigurimin e ndihmës humanitare.

Trajnimet simuluese janë mënyrë e shkëlqyeshme për testimin e supozimeve dhe procedurat e planit për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente, posaçërisht kur resurset dhe koha janë të kufizuara. Nëpërmjet simulimeve dhe trajnimeve duhet të paraqiten skenaret për të cilat ekziston mundësi e madhe se mund të ndodhin. Pjesëmarrësit duhet të nxiten që të luajnë role dhe funksione të posaçme siç është paraparë në planin për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente.

Simulimet e trajnimeve simuluese do t'i paraqesin anët e forta dhe të dobëta të planit. Në rrethana ideale, trajnimet simuluese duhet të jenë sistematike me kyçje të të gjitha komponentave të cilat do të ishin të kyçura në situata gjatë katastrofës së caktuar (p.sh. shoqata nacionale, agjencitë qeveritare, organizatat joqeveritare dhe institucionet tjera).

Shumica e simulimeve dhe trajnimeve nuk mund ta pasqyrojnë të gjithë dinamikën dhe kaosin si në raste të katastrofave të vërteta. Më tej, pjesëmarrësit mund të angazhohen në trajnime simuluese me gjysëm orvatje. Megjithatë, kjo nuk duhet të jetë falje për tejkalimin e nevojës për testim; kjo është diçka më e afërt që mund të bëhet, para katastrofës së vërtetë, që të mund të shihet se a është plani efikas për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente.

Simulimet dhe trajnimet gjithashtu ndihmojnë që të potencohen aspektet të caktuara në programe të ndryshme për trajnim dhe të testohet sistemi në tërësi. Trajnimet shpesh herë paraqesin mangësi në planet për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente të cilat në mënyrë tjetër nuk mund të shihen.

Simulimet dhe trajnimet janë mënyrë e dobishme për kontrollimin e planeve, posaçërisht në periudha kur nuk ndodh katastrofa në një periudhë më të gjatë kohore, dhe pas organizimit të tyre duhet të vijojnë diskutime që janë të nevojshme të bëhet përshtatja dhe modifikimi i planeve me qëllim që të përmirësohen.

Ripërtrirja dhe evaluimi i planit

Pas finalizimit të versionit të parë në planin për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente, me rëndësi është që të përcaktohet se a veprojnë bashkë struktura dhe përmbajtja e planit në kapacitetet për përgjigje në katastrofa. Në pjesën e mëparme pamë se ekziston nevojë që planet të testohen dhe në bazë të mësimave dhe konkluzave të mësuara, të bëhen ndryshimet e duhura. Gjithashtu është me rëndësi të njihet se planet për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente mund të vjetrohen si rezultat i ndryshimeve shoqërore, ekonomike, organizative e tjera, që kanë ndodhur pas përgatitjes initiale të planeve.

Sfidë e madhe është që planet për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente të jenë vazhdimisht të azhuruara dhe të jenë relevante, por kjo mund të bëhet nëpërmjet revidimit të tyre të rregullt. Në plan duhet të vërtetohet se sa shpesh do të bëhen revizionet e tilla (p.sh. në çdo gjashtë muaj, çdo vit etj.) dhe personat të cilët janë përgjegjës për ripërtrirjen e planit. Informacionet të cilat duhet vazhdimisht të ripërtrihen janë:

- Kontakt informacionet e përfaqësuesve dhe agjencive përgjegjëse për veprim gjatë situatave urgjente (numri i telefonit, faksi dhe celulari, e-mail adresa etj);
- Planet logjistike për transport;
- Qasje në strukturat për situata urgjente; dhe
- Lista e resurseve të kapshme.

Procesi i ripërtirjes së procedurave i cili është i theksuar në planet për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente mund të jetë shumë i thjeshtë dhe ai duhet t'i përmbajë bile elementet në vijim:

Cilat pjesë të planit duhet të ripërtrihen?

Kontrollim në detaje të pjesëve të planit të cilat duhet të ripërtrihen. Nuk duhet të ripërtrihen të gjitha elementet me frekuencë të njëjtë apo në mënyrë të njëjtë.

Kur apo sa shpesh duhet të ripërtrihet plani?

Definoni qartë frekuencën për ripërtirjen e informacioneve në secilën pjesë të planit. Këtë bëjeni në pajtueshmëri me rëndësinë e informacioneve dhe frekuencën të cilën e prisni që do të nevojitet në bazë të ndryshimit të gjendjeve. Për shembull, gjithçka që ka të bëjë me resurset do të ndryshojë më shpesh se sa të dhënat lidhur me kontekstin e përgjithshëm. Në përgjithësi, planet për situata të mundshme urgjente duhet të ripërtrihen më shpesh se sa planet për përgjigje gjatë katastrofave.

Si apo me cilën metodologji duhet të ripërtrihet plani?

Metodologjia më adekuate duhet të përdoret në pajtueshmëri me pjesën e planit i cili duhet të ndryshohet. Segmente të caktuara të planit mundën lehtë të ripërtrihen nëpërmjet konsultimit të ueb faqeve apo dokumenteve institucionale strategjike, përderisa për pjesë tjera ndoshta do të ketë nevojë konsultime më të mëdha, evulim apo zbatim të trajnimeve simuluese.

Kusha ka përgjegjësi për ripërtirjen e informacioneve në pjesë të ndryshme?

Përgjegjësitë për ripërtirjen e informacioneve në pjesë të ndryshme të planit duhet të ndahen, me qëllim të mënyrës maksimale optimale të përdoren resurset ekzistuese organizative. Normalisht, menaxhuesit për resurse njerëzore i ripërtirjnë informacionet lidhur me kapacitetet, përderisa skenaret dhe strategjitë për përgjigje janë përgjegjësi e drejtorëve programues apo personave teknik. Rekomandohet që një person ta udhëheqë procesin e përgjithshëm të ripërtirjes së informacioneve në plan.

Çfarë resurse nevojiten për ripërtirjen e planit?

Përderisa nevojiten resurse plotësuese për ripërtirjen e planit, kjo duhet të theksohet dhe paraqitet në buxhetin e shoqatës nacionale.

Regjistrim ur janë bërë ndryshimet në plan

Është shumë me rëndësi të ketë një regjistër në bazë të asaj se kur janë bërë ndryshime në planin për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente. Ky regjistër duhet të përmbajë të dhëna në bazë të numrit të kopjeve të përgatitura në plan dhe kush i ka marrë, me qëllim që personat e njëjtë të mundën ta marrin planin e ripërtirë.

Gjithashtu mund të evaluohet validiteti dhe përdorimi i planit për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente pasi të implementohet në situata reale, si për shembull pasi të ndodhë katastrofa. Evaluimet duhet të bëhen shpesh nëpërmjet përdorimit të të dhënave reale – në bazë të metodologjive të ndryshme, varësisht nga ajo se a është zbatuar evaluimi gjatë operacionit për përgjigje gjatë katastrofave apo pasi të ndodhë katastrofa.

Evaluimi i zbatuar gjatë kohës së operacionit për përgjigje gjatë katastrofës dhe pasi të ndodhë katastrofa

Testimi i duhur i planit është gjatë implementimit të tij gjatë operacioneve për përgjigje gjatë katastrofave. Operacioni për sigurimin e përkrahjes paraqet tekstin e vërtetë të konceptit për planifikim dhe supozim. Evaluimi i operacioneve jep mundësi të vërtetohet se sa është i mirë koncepti i operacionit, sistemi i menaxhimit, procedurat dhe proceset dhe çështjet tjera operative lidhur me implementimin e planit.

Gjatë një ngjarje të caktuar, personi apo grupi i personave (të cilët zakonisht llogariten për persona të jashtëm nëse nuk kanë obligime në implementimin e planit apo nëse përkrahja e tyre nuk është e patjetërsueshme) caktohen që të jenë vëzhgues gjatë ditëve të para të implementimit të planit. Ato përdorin kriteret dhe tregues paraprakisht të vërtetuara për evaluimin e aspekteve të ndryshme në plan me qëllim që të nxjerren konkluzat, mësimet të mësuara si dhe aktivitete të cilat janë të patjetërsueshme për përmirësimin e planit. Ky lloj i evaluimit ka vlerë të posaçme gjatë situatave urgjente vëllimi dhe kompleksiteti i së cilit (p.sh. gjatë involvimit të shumë organizatave humanitare, apo kur katastrofa godet më shumë vende etj.) shpie vëzhgim të kujdesshëm.

Metodat të cilat mund të përdoren për zbatimin e evaluimit janë: përdorimi i të dhënave sekondare (raporte të evaluimeve të ngjashme dhe/apo agjenci, gazeta, evaluime tjera); intervista (nëpërmjet fokus grupeve, pyetësorëve, intervistave me persona dhe përdorues kyç); dhe vëzhgim të drejtpërdrejtë. ,e të gjitha metodat, identifikohen çështje dhe rekomandime kyçe që të sigurohet se planet dhe operacionet e ardhshme për ndihmë do të shpërblehen në sukseset dhe realizimet dhe se do të jenë në mundësi me sukses të përgjigjen në sfidat në fushat e ndryshme problematike.

Për shkak të kësaj mund të përfundojmë se nevojitet qasje agresive dhe e vazhdueshme në bazë të veprimit në konkluzat dhe rekomandimet kyçe të cilat do të dalin nga procesi i evaluimit.

Përgjegjësi për evaluim të planeve për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente

Plane për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente të shoqatave nacionale

Shoqatat nacionale e përcaktojnë përmbajtjen dhe formatin e duhur të planeve personale për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente si dhe proceset të cilat përdoren për evaluimin e këtyre planeve. Udhëheqësia e shoqatës nacionale duhet të kërkojë evaluim formal në secilin plan për përgjigje gjatë katastrofave të organizatave komunale të Kryqit të kuq i cili duhet të zbatohet së paku një herë në tre vjet. Megjithatë, plani duhet të evaluohet edhe kur do të ketë ndryshim të rëndësishëm në përmbajtjen e tij, si dhe pas ndodhjes së secilit operacion më të madh për përgjigje gjatë katastrofave në vend.

Personeli teknik për menaxhim me katastrofa të Federatës ndërkombëtare mund të ndihmojë në përgatitjen, evaluimin dhe revidimin e këtyre planeve, në kërkim të shoqatave nacionale. Së bashku me delegacionet rajonale, shoqatat nacionale duhet të bëjnë evaluimin e planeve të veta për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente në çdo tre vjet.

Plane për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente të Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe

Njësia për koordinim dhe programim të Federatës ndërkombëtare do të zbatojë evaluim formal të planeve rajonale për përgjigje gjatë katastrofave një herë në çdo tre vjet; gjithashtu do të bëjë revidim vjetor që të sigurojë se planet i përshkruajnë dhe mbulojnë të gjitha elementet me çka mundësohet koordinimi në Lëvizje dhe sigurohet përgjigje adekuate gjatë katastrofave në mënyrë efektive dhe në kohë.

Federata ndërkombëtare ka përgjegjësi të bëjë evaluimin e planeve për situata urgjente në fusha me rrezik të lartë në bazë vjetore – nëpërmjet zbatimit të trajnimeve me shoqatat nacionale apo nëpërmjet evaluimit bazuar në operacion të madh për sigurimin e ndihmës humanitare gjatë katastrofës. Përgatitja e planeve për shëfat e delegacioneve dhe koordinatorëve për menaxhim me katastrofa të Federatës ndërkombëtare.

Kreu 5

Standarde për plane, llogaridhënie dhe lidhshmëri

Ky udhëzim ka për qëllim të sigurojë këshilla dhe propozime të cilat do t'ju ndihmojnë menaxhuesve për katastrofa të përgatisin plane me kualitet të lartë, relevante dhe të dobishme për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente. Kjo është vetëm për shkak të asaj që përgjigja gjatë katastrofave bie në kuadër të mandatit të shoqatave nacionale por kjo është edhe obligim ndaj njerëzve të cilëve iu nevojitet përkrahje nga Kryqi i kuq / Gjysmëhëna e kuqe dhe jeta e së cilëve varet nga koha e situatës në krizë. Planet për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente patjetër të jenë në favor të përdoruesve të shërbimeve dhe të plotësojnë standarde më të larta në bazë të përvojave të cilat hasen me shumë punë dhjetra vjeçare në planin e veprimit gjatë katastrofave.

Ky udhëzim vazhdimisht thekson se veprimi gjatë katastrofave dhe planifikimit për situata të mundshme urgjente janë procese të cilat nuk mund të zbatohen ndaras. Me qëllim që të jenë planet relevante dhe të dobishme për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente patjetër duhet të jenë rezultat i orvatjeve kolaborative. Ato gjithashtu patjetër duhet të lidhen me planet, sistemet apo proceset e trupave tjerë joqeveritarë, partneror të Lëvizjes në të gjitha nivelet – nacional, rajonal dhe global.

Standarde dhe llogaridhënie

Gjatë përgatitjes së planeve për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente, rekomandojmë që planifikuesit të kenë kujdes dhe t'i përdorin politikat, rregulloret, standardet dhe treguesit të cilët tani më janë të gatshëm për këtë qëllim. Këtu mendojmë në Marrëveshjene Sevilijs dhe në Masat plotësuese, Sfera dekreti humanitar dhe standardet minimale për përgjigje gjatë katastrofave, Kodin e sjelljes të Lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe organizatave joqeveritare gjatë operacioneve për ndihmë gjatë katastrofave, Kodit për sjelljen e të punësuarve, Parimet dhe rregullat e Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe gjatë operacioneve për ndihmë gjatë katastrofave, Parimet themelore të Lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe politikat për menaxhim me katastrofa të Federatës ndërkombëtare, Udhëzimin për shoqata nacionale të përgatitura mirë dhe Iniciativa për programim të mirë.

Këto dokumente mund të zbatohen me qëllim që të promovohen dhe sigurohen standarde dhe llogaridhënie; gjithashtu mund të përdoren gjatë përgatitjes së treguesve planifikues për definimin e supozimeve, dhe mund të përdoren për përcjelljen dhe evaluimin e ndikimit të operacioneve për përgjigje gjatë katastrofave.

Definitivisht, të gjitha këto mjete kanë për qëllim të sigurohet kënaqja e nevojave themelore të popullatës së goditur nga katastrofa në bashkësitë gjatë operacioneve për sigurimin e përgjigjes gjatë katastrofave.

Standarde dhe llogaridhënie – pyetje të cilat duhet të merren parasysh gjatë katastrofave

Vlerësimi

Në vlerësimin fillestar të kyçen çështjet për qasje, ngritje të vetëdijes, dhe kuptim të parimeve themelore, Sfera, Kodi i sjelljes, Marrëvreshja e Seviljës, dhe aspektet e përgjithshme lidhur me mbrojtjen e përgjithshme. Në pajtueshmëri me këtë duhet të planifikohen aktivitete programore, me qëllim që të promovohen dhe përparohen këto aspekte.

Qasje në informacione

Të sigurohen doracakë të mjaftueshëm që të mund njerëzit të kenë qasje në informacione kur do të ketë nevojë. Të përkthehen doracakët në gjuhët lokale me qëllim që të mundet më mirë të kuptohen dhe pranohen.

Trajnim

Rregullisht të zbatohen trajnime elementare dhe freskuese për personelin në gjuhët lokale. Të zbatohen trajnime për mjete të reja për të punësuarit dhe vullnetarët.

Avokativitet

Të komunikohet nevoja për respektimin e standardeve dhe rëndësinë e parimeve themelore, Kodin e sjelljes, Marrëvreshja nga Sevilja dhe Masat plotësuese dhe Parimet dhe Rregullat për ndihmë gjatë katastrofave në Lëvizjen e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënën e kuqe. Të dokumentohet dhe lajmërohet për punën e zbatuar në bazë të mjeteve siç janë Sfera, me qëllim që të tregohet zbatimi i tyre dhe të nxitet përkrahja e donatorëve.

Monitorim

Të vëzhgohet respektimi i standardeve dhe parimeve dhe të identifikohen fusha ku është e nevojshme puna e mëtutjeshme. Në kuadër të zbatimit të planit monitorues të projektimit mund të përdorni *Karakteristikat për shoqata të përgatitura mirë, Sfera dhe parimet e Kodit për sjellje*.

Evalui

Zbatimi i evaluimit në bazë të respektimit të standardeve për shoqata nacionale të përgatitura mirë dhe identifikimi i mësimave të mësuara dhe fusha për përmirësim të mëtutjeshëm.

Siç ishte përshkruar në kreun e mëparshëm, planet patjetër në mënyrë të vazhdueshme të përcjellen dhe ripërtrihen që të ruhet efikasiteti i tyre. Nëse evaluohet plani për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente pasi të ndodhë situatë e mundshme e caktuar, delegacionet e Federatës ndërkombëtare dhe shoqatave nacionale mund t'i revidojnë planet me qëllim që të reflektohet realiteti, mundësitë dhe sfidat të cilat në mënyrë reale kanë dalë gjatë veprimit në katastrofa.

Pyetjet të cilat duhet të parashtrohen gjatë kohës së revidimit në plan mes tjerash janë:

- Cilat kanë qenë anët e dobëta dhe të fuqishme në planin për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente? Si mund të modifikohet apo përmirësohet plani?
- Çka është ajo që ka shkaktuar humbje dhe dëme më të mëdha njerëzore? Çka, nëse ekziston një gjë e tillë, a munden shoqatat nacionale të bëjnë që kjo të lehtësohet apo ndalohet në të ardhmen?
- Cilat kanë qenë vështirësitë kryesore në sigurimin e përkrahjes humanitare për personat me nevoja? Si mundet që shoata nacionale ta tejkalojë këtë në të ardhmen?
- Si ka funksionuar sistemi për paralajmërim? Cilat përmirësime janë të nevojshme?
- Cilat gabime janë bërë? Cilat ndryshime duhet të bëhen që të tejkalohen këto gabime në të ardhmen?
- Çka është ajo që është bërë mirë? Cilat hapa mund të ndërmerren që të sigurohet se shoqata nacionale do të vazhdojë t'i ruajë këto standarde?
- Çfarë lloji të ndihmës ka qenë e kapshme e cila ka munguar? Si mund të tejkalohen mangësitë në të ardhmen?
- Si ka qenë koordinimi mes shoqatës nacionale dhe partnerëve të jashtëm? Çfarë koordinimi plotësues nevojitet? Si mund të përmirësohet koordinimi në të ardhmen?

Lidhshmëria mes mjeteve nacionale, rajonale dhe ndërkombëtare (prej nivelit lokal kah ai global)

Për shkak se katastrofat nuk dijnë për kufij, është shumë me rëndësi që planet e përgatitura në nivel nacional të shoqatave nacionale të jenë të inkuorpuara në plane rajonale. Në rast të situatave urgjente komplekse, ndonjëherë është më lehtë të parashikohet se a do të goditet një apo më shumë vende fqinje. Këto elemente duhet të jenë evidente gjatë procesit të planifikimit (shiko Aneksi 11). Delegacionet rajonale të Federatës ndërkombëtare punuan vazhdimisht gjatë viteve të kaluara që të sigurojnë shpërndarje të shpejtë të resurseve në vendet / rajonaet e goditura nga katastrofat. Në këtë plan u siguroja trajnim dhe pajisje të ekipeve për përgjigje gjatë katastrofave (komunale, nacionale dhe rajonale), si dhe zbatim të bazave logjistike dhe pozicionim të rezervave me ndihma humanitare.

Aftësia e delegacioneve rajonale të përgjigjen shpejtë dhe në mënyrë adekuate është drejtpërsëdrejti e varur nga njohja e tyre me planet për përgjigje gjatë katastrofave dhe situatave të mundshme urgjente me qëllim që të ketë qasje në situatat urgjente për të cilat ka mundësi të madhe se do të ndodhin në ndonjë vend të caktuar. Shoqatat nacionale apo delegacionet e Federatës ndërkombëtare në vendet patjetër të kujdesen menaxhuesit rajonal për katastrofa të jenë të informuar apo sipas mundësisë, të kyçur në përgatitjen e planeve nacionale.

